



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
“Drejtimit i Ndërmarrjeve Turistike”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër  
Moisiu”, Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica

2. Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha

Prill/2020

# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

## Përshkrim përmbledhës 200 - 400 fjalë

Programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike” (MP DNT), është një program i ofruar nga Fakulteti i Biznesit (FB), Departamenti i Turizmit, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD). Është një program i ri, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 655, datë 11.10.2018, i cili ka filluar veprimtarinë akademike të tij në vitin akademik 2018-2019.

Programi i studimit realizohet me 60 ECTS, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik/2 semestra, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi MP DNT është një nga programet Master Profesional në degën e turizmit në hapësirën e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Përgjithësisht, Institucionet e Arsimit të Lartë të cilat janë të vendosura në zonat turistike të Shqipërisë kanë mbështetur ofrimin e programeve në degën e turizmit, për të mundësuar mbështetjen e tregut të punës në këtë sektor shumë të rëndësishëm dhe strategjik për Shqipërinë. Në këtë drejtim, edhe UAMD në FB ka patur synim të paraqesë ofertën e tij, fillimisht me diplomat e nivelit të parë dhe më tej, duke u bazuar në kërkesën e studentëve për të mbështetur formimin e tyre edhe në ciklin e dytë të studimeve, duke aplikuar kështu për të ofruar edhe MP në DNT. Sigurisht, bazuar mbi kërkesat e studentëve, kjo është një iniciativë që plotëson ofertën me programe nga ana e FB, por ajo çfarë duhet të nxisë mënyrën se si kjo diplomë do të ofrohet në të ardhmen duhet të jetë kërkesa në tregun e punës, e cila gjithashtu nuk mungon.

Aktualisht, programi i MP DNT përqipet të ndërtojë kompetenca bazë në të gjitha aspektet e drejtimit të ndërmarrjeve në fushën e turizmit, si në analizën financiare, në marketing dhe komunikim, në menaxhim dhe mikpritje, sistemet kulturore territoriale, burimet njerëzore. Në këtë aspekt, lëndët kanë profilin e bazave të menaxhimit, financës, marketingut dhe një përshtatje me fushën e turizmit, më tepër se sa një specializim të mirëfilltë në drejtimin e ndërmarrjeve turistike. Kjo strategji në ndërtimin e kurrikulës është menduar për të tërhequr edhe studentët e bachelor-it që kanë ndjekur degë të tjera, si histori, gjeografi, gjuhë të huaja, shkenca të tjera humane. Një orientim më i mirë dhe një lidhje më e fortë me sektorin e sipërmarrjeve turistike, në akomodim, agjenci dhe ndërmarrje të tjera, duke bashkëpunuar për punësimin e studentëve produkt i këtij masteri do të kontribuojë më mirë në përmirësimin e kurrikulës në të ardhmen.

Gjithashtu, ndërtimi i kurrikulës është dhe rrjedhim i stafit akademik të programit, i cili ka në përbërje edhe pedagogë të cilët nuk e kanë formimin parësor dhe në nivel doktore atë të

turizmit, menaxhimit në turizëm apo marketing si fusha të lidhura. Vetëm trajnimet dhe pjesëmarrja në projekte nuk mund të përbëjnë bazën e duhur në ndërtimin e një kurrikule të fortë dhe mbështetjen në staf akademik i cili duhet të mbështesë menaxhimin e ndërmarrjeve turistike, që sot po ofrojnë shërbimet e tyre në një sërë fushash dhe aspektesh brenda zinxhirit të vlerës, si akomodim, marketing i destinacionit dhe produktit turistik, guida turistike dhe operatorë të tjerë.

Në të ardhmen, ky program masteri duhet të gjejë rrugën e vet në hapësirën e programeve në fushën e turizmit për tu diferencuar dhe për të ndërtuar një profil të qartë, që ta dallojë atë nga programet e tjera si dhe të tërheqë operatorët për të bashkëpunuar në identifikimin e burimeve njerëzore më të mira në fushën e turizmit, sidomos në menaxhimin e ndërmarrjeve të turizmit.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë**

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimtarinë e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht kontaktin me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, ekspertë në përbërje të të cilit kanë qenë dhe më parë të angazhuar si ekspertë pranë ASCAL dhe njohin standardet e cilësisë dhe kriteret, si dhe përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit. Vendosja e një komunikimi të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe koordinatorit teknik nga ASCAL është e rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për programin përkatës, u hartua një agjendë për vizitën në institucion, për të cilën u dakordësua midis grupit të punës. Hapi i rradhës ishte realizimi i saj. Agjenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat do të ndikonin në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Prof. Asoc. Ermelinda Kordha. Gjatë të gjithë procedurës ky grup pune u asistua dhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Zj. Ersi Dako. Pas vizitës në Institucion, u hartua Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm nga ekspertët e jashtëm, i cili u dorëzua në ASCAL për ta përcjellë në IAL.

Më datë 17.03.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 4/37 Prot., datë 17.03.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 02.04.2020.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit dhe pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL-së, argumenton si në vijim:**

Lidhur me gjykimin në hyrje të reflektimit mbi rëndësinë strategjike të këtij programi studimi, GVJ gjykon se është e drejtë, por në kundërshtim me çka analizohet në këtë pjesë, duhet të dakordësojmë se, bazuar mbi nevojat e vendit tonë, për njohuri të cilat vijnë nga zhvillimet aktuale jo vetëm të sektorit të turizmit por edhe të dijeve në përgjithësi, duhet të ndërtohen kurrikula që ofrojnë dije dhe paraprijnë çdo strategji të mëtejshme.

IAL-të, duhet të jenë pionier të ndërtimit të strategjive të ardhme, pra përgjegjësia për kurrikula cilësore është edhe më e madhe kundrejt përgjegjësisë që kemi të gjithë për zhvillimin mbarëkombëtar të vendit.

1. Në lidhje me komentin 1 të IAL për fushën 1, standardi 1.2, kriteri 2, GVJ gjykon se nuk qëndron pasi: Departamenti ka përgjegjësinë të realizojë një program studimi, rrjedhimisht janë dokumentat mbështetëse si rregulloret dhe dokumentat funksionale që mbështesin, argumentojnë dhe japin bazën e fortë të dakordësuar mbi të cilën më tej ndërtohet, ngrihet dhe funksionon ky program studimi. Përderisa këto dokumenta strategjike nuk përkojnë në të njëjtën kohë me këtë program studimi, lind me të drejtë shqetësimi mbi funksionimin normal të tij. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

2. Në lidhje me komentin 2 të IAL për fushën 1, standardi 1.2, kriteri 3, GVJ gjykon se diskutimi është bërë për emërtimin e diplomës, formulimin e tij dhe përshtatjen në anglisht të diplomës që merr studenti. Theksojmë edhe njëherë se vërtet që janë edhe elementë të tjerë që ndikojnë në mënyrë definitive në ekuivalentimin e diplomës, por në këtë standard po diskutohet dhe rrjedhimisht vlerësohet emërtimi i diplomës dhe jo elementët e tjerë. Përpos kësaj, duhet të shtojmë se emërtimi nuk është thjesht një “cover” për të mos u vlerësuar kundrejt elementëve të tjerë, përkundrazi ka peshë, domethënie dhe jo rrallë herë prezanton brendësinë e njohurive të një masteri. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

3. Në lidhje me komentin 3 të IAL për fushën 1, standardi 1.2, kriteri 4 dhe standardi 1.3 kriteri 1, GVJ gjykon se nuk qëndron si argument sepse bazuar nga të gjitha dokumentat e vëna në dispozicion, të konsultuara përgjatë vlerësimit, rezulton se:

- a. Jo vetëm që ishte totalisht i munguar studimi i tregut, por dokumenta të caktuara kishin emërtesë studim tregu duke mos qenë të tilla, ndërkohë që edhe RVB konfirmonte se ka studim tregu. Kjo paqartësi u sqarua edhe gjatë vizitës në Institucion, ku edhe përgjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, u konfirmua mungesa e këtij studimi. Ky konfirmim më pas u përfshi nga GVJ edhe në RVJ;
- b. Lidhjet e vazhdueshme që mbajnë anëtarë të caktuar të departamentit me struktura publike dhe përgjegjëse në sektorin e turizmit, janë pjesë e punës personale të gjithësecilit, jo vetëm për ngritje profesionale por edhe mbështetje të sektorit dhe nuk mund të përbëjë studim tregu.

Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

4. Në lidhje me komentin 4 të IAL, fusha 1, standardi 1.2, kriteri 3, GVJ gjykon se, përveç argumentit të detajuar (të cilin do të sugjeronim të riletë me kujdes edhe njëherë) të përfshirë në RVJ, edhe nga diskutimet në institucion me studentët apo me stafin, u diskutua ajo çka kishte konfirmuar GVJ nga ballafaqimi me dokumentacionin, pra se: takimet dhe përfshirja e studentëve në institucione që nuk përbëjnë targetin e diplomimit, nuk mund të jenë vende për të kryer praktikën. Diplomimi i kësaj kategorie studentësh është bërë për ndërmarrjet turistike, jo për njësitë publike brenda apo jashtë ministrisë së kulturës. Informimi dhe qëndrimi pranë tyre është patjetër i rëndësishëm, por jo targeti i duhur i formimit që i duhet studentëve. Madje, për të shtuar, mund të ritheksojmë se numri relativisht

mjaft i ulët prej 12 studentësh kundrejt mbi 700 strukturave hoteliere, do të përbënte luks për çdo IAL. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

5. Në lidhje me komentin 5 të IAL për fushën 1, standardi 1.3, kriteri 3, GVJ gjykon se, IAL ka renditur disa shënime të GVJ për këtë kriter por nuk është dhënë asnjë argument përse gjykohet se nuk qëndrojnë. Lidhur me komentin mbi lëndën “Metoda Kërkimi”, nga IAL është shtuar edhe argumenti se përderisa profili është i tillë që mund të vijnë studentë nga degë të ndryshme, të cilët mund të kenë bërë apo jo metoda kërkimi më parë, GVJ mban të njëjtin qëndrim të shprehur në raport dhe shton si argument ekstra se pikërisht metodat e kërkimit nuk mund të bëhen për çdo profil hyrës të studentëve. Kështu p.sh., studentët e profilit ekonomik kanë një background relativisht të mirë paraprak, ndërsa ata të shkencave shoqërore mund të mos e kenë, përforcuar dhe me argumentin se masteri profesional nuk ka nevojë për metoda kërkimi se sa për një shportë të diversifikuar të lëndëve që i duhen tregut dhe profilit të diplomës. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

6. Në lidhje me komentin 6 të IAL për fushën 1, standardi 1.3, kriteri 6, GVJ mban të njëjtin qëndrim, që sugjeron orientim të profilit të kryerjes së praktikave në institucione që quhen ndërmarrje turistike, por ky gjykim bazohet edhe nga mosrealizimi konkret i marrëveshjeve të bashkëpunimit me ndërmarrjet turistike për të cilat ekzistojnë marrëveshje të shkruara. Në raste të tilla, këto njësi bazë duhet të shërbejnë si laboratore inovative ku të gjejnë zgjidhje problemet e qindra ndërmarrjeve ekzistuese në rajonin e Durrësit. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

7. Në lidhje me komentin 7 të IAL për fushën 1, standardi 1.4, kriteri 1-3, GVJ gjykon se, përveç argumentimit në RVJ, departamenti, si njësi bazë dhe ekzekutive, duhet të synojë të përafrojë në programe të tilla studimi ekspertë të fushës që përveç viteve dhe eksperiencës, të sigurohet ofrimi i njohurive të duhura, jo të përgjithshme, por të përshtatura fushës. Në këtë mënyrë, programe të tilla studimi, që nuk janë ndërdisiplinore, duhet të sigurojnë thellimin e njohurive brenda konceptimit të ndërmarrjeve turistike. Gjykohet se, në lidhje me burimet akademike që mbështesin dhe sigurojnë një cilësi mësimdhënieje dhe garantojnë ofrimin e njohurive të duhura, nga konsultimi me dokumentacionin, CV dhe përputhjen e stafit me modulet përkatëse, gjykohet se nuk është bërë një përputhje cilësore e formimit bazë të çdo pedagogu me lëndën në këtë program studimi. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

8. Në lidhje me komentin 8 të IAL për fushën 1, standardi 1.6, kriteri 2-4, GVJ gjykon se, IAL, në gjykimin që ka bërë për vlerësimin e GVJ për këto pika, bazohet në një argument që përfshin aktivitetin e fakultetit, ndërsa vlerësojmë këtë program studimi dhe rrjedhimisht njësinë bazë (departamentin) që e ofron. Sigurisht që çdo program studimi bazohet në politikat e institucionit (universitetit) e qasjen e fakultetit, por bazohet në njësinë bazë, pasi është kjo bërthamë e cila përmes kërkimeve, studimeve, përfshirjes së studentëve të këtij

profili masteri, stafit dhe tryezave të organizuara, ofron qasjen totalisht ndaj këtij profili masteri. Përveç kësaj, shtohet edhe argumenti se, numri i madh i njësive/ndërmarrjeve turistike, u mundëson totalisht ofrimin e praktikave por edhe të çdo lloj aktiviteti, këtij numri të vogël studentësh që mbyllin këtë program studimi. 12 studentë të diplomuar kundrejt një shifre 700 ndërmarrjesh turistike, është një komoditet i konsiderueshëm për të mos dërguar studentët për të bërë praktikën në bashkitë e Burrelit apo Peshkopisë. Ndërsa në lidhje me pikën 2 të këtij komenti, GVJ gjykon se, përpos referimit më sipër të akomodimit të studentëve për praktika mësimore në ndërmarrje turistike brenda rajonit (pasi studentët supozohet t'i shërbejnë së pari tregut të synuar që janë ndërmarrjet turistike të Rajonit të Durrësit, e më tej më gjerë), elementët praktikë studentët duhet në fakt t'i kenë përfutur në masë të madhe edhe në lëndë specifike brenda strukturës së programit mësimor, por që lidhen direkt me profilin e ndërmarrjeve turistike. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

9. Në lidhje me komentin 9 të IAL për fushën 1, standardi 1.5, kriteri 5, GVJ gjykon se, sikurse përmendur edhe në pikën 4 si më lart, përveç argumentit të detajuar (të cilin do të sugjerohet të riletë me kujdes edhe njëherë) të përfshirë në RVJ, edhe nga diskutimet në institucion me studentët apo me stafin, u diskutua ajo çka kishte konfirmuar GVJ nga ballafaqimi me dokumentacionin, pra se: takimet dhe përfshirja e studentëve në institucione që nuk përbëjnë targetin e diplomimit, nuk mund të jenë vende për të kryer praktikën. Diplomimi i kësaj kategorie studentësh është bërë për ndërmarrjet turistike, jo për njësitë publike brenda apo jashtë ministrisë së kulturës. Informimi dhe qëndrimi pranë tyre është patjetër i rëndësishëm, por jo targeti i duhur i formimit që i duhet studentëve. Nga konsultimi i listës emërore të studentëve të këtij masteri me atë çka është vendosur në profilin e fb të cropuar dhe përfshirë si dokumentacion, u vu re se (sikurse është bërë edhe shpjegimi në RVJ) studentët të përfshirë në aktivitete të caktuara nuk i përkasin këtij grupi të studentëve që diplomohen. Edhe nga komunikimi me stafin u pranua se janë studentë të bachelorit. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

10. Në lidhje me komentin 10 të IAL për fushën 1, standardi 1.5, kriteri 6, GVJ gjykon se, komentet që IAL ka bërë, lidhen me sfidat që i përkasin të ardhmes kundrejt analizës që GVJ ka bërë për këto standarde. Nuk gjykojmë se çfarë do të bëhet në të ardhmen dhe kemi besim se cilësia dhe përfshirja e këtij masteri në struktura të ndërmarrjeve turistike, në përfshirje apo aktivizim konkret të bashkëpunimeve me ministrinë dhe institucione të tjera publike të lidhura me profilin e masterit, por edhe përfshirja e ekspertëve, do të jenë cilësisht prezente në të ardhmen. Por, ndërkohë, theksojmë se GVJ gjykon mbi bazën e fotografimit aktual dhe konkret të situatës, bazuar në dokumentacion dhe vizitën në Institucion. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

11. Në lidhje me komentin 11 të IAL për fushën 2, standardi 2.1, kriteri 2, GVJ gjykon se, mbështetet në argumentimin bazik që kufizohet më tepër edhe nga mungesa e lëndëve me zgjedhje. Në reflektim të kësaj mungese dhe organizimit aktual të lëndëve, për të orientuar në formimin e shprehive në një llojshmëri të gjerë profesionale, mund të ndërmerret orientimi


Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



në profesione në dy aspekte brenda menaxhimit të ndërmarrjeve turistike, ose në ndërmarrje të ndryshme brenda zinxhirit të vlerës në turizëm, ose në profesione që lidhen me funksionet më të kërkuara në të gjithë tregun turistik, ku mund të përmendim marketingun, teknologjinë dixhitale, etj. Ky koment qëndron në formën e një sugjerimi për të ardhmen, për të përfshirë sa më shumë lëndë e module me zgjedhje që lidhen direkt dhe indirekt me profilin e masterit, por edhe janë të një rëndësie strategjike për rritjen e ndërmarrjeve turistike lokale dhe kombëtare. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

12. Në lidhje me komentin 12 të IAL për fushën 2, standardi 2.1, kriteri 3-7, GVJ gjykon se, së pari, çdo kualifikim afatshkurtër që mund të bëjë çdo anëtar i stafit, nuk përbën argument për justifikimin e lëndëve. Gjykimi i GVJ është bazuar në faktin se dhënia e moduleve duhet të bazohet tek kompetencat bazë që ka çdo anëtar i stafit, më tej ai/a jo fuqizon kapacitetet e veta në lëndë specifike, por nuk duhet të ngatërrohen kompetencat nga formimi bazë me atë çka mund të bëjë përgjatë kohës së mësimdhënies, që sigurisht rrisin specilizimin e stafit, që ndërkohë janë detyrime që të gjithë kanë ndaj vetes, formimit të gjithsecilit dhe detyrimit ndaj studentëve për të sjellë njohuri dhe risi nga vendi dhe bota. Përplasjet e përmbajtjes së lëndëve midis njëri-tjetrit, 2 apo 3 lëndë kanë tema të përbashkëta e kjo krijon vetëm konfuzion tek studentët, apo njohuri të panevojshme që nuk ndihmojnë as stafin dhe as studentin. Forcimi i kompetencave të stafit do të thotë rritje cilësore brenda secilës lëndë që japin tek studentët, krahasime dhe diskutime midis stafit për mospërplasje të nocioneve, lëndëve apo terminologjive. Në RVJ janë paraqitur këto përplasje në mënyrë të detajuar për secilën lëndë. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

13. Në lidhje me komentin 13 të IAL për fushën 2, standardi 2.3, kriteri 2, nuk ka koment pasi IAL dakordëson gjykimin e GVJ.

14. Në lidhje me komentin 14 të IAL për fushën 2, standardi 2.3, kriteri 3, GVJ gjykon se, gjykimi, është bërë si mbi bazën e krediteve, ashtu edhe mbi shpërndarjen e njohurive në të gjithë vitin akademik. Programi i studimit DNT organizohet në lëndë sipas sistemit të krediteve, ku 1 kredit është 25 orë mësimore, është ndarë sipas ngarkesës në auditor dhe jashtë auditorit dhe gjithashtu ka një ndarje të lëndëve në semestra, me një ngarkesë prej 5 lëndë në semestrin e parë, me 27 kredite, gjithsej 675 orë të punës së studentit dhe semestrin e dytë 3 lëndë, praktika profesionale dhe mikroteza, një ngarkesë prej 33 kreditesh ose 825 orë pune të studentit. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

15. Në lidhje me komentin 15 të IAL për fushën 2, standardi 2.3., kriteri 6, GVJ, gjykon se, përpos asaj çka është përmendur në RVJ, thekson se nuk ka një program për praktikën dhe një plan për orët jashtë auditorit është thujse në mungesë, pasi nuk përshkruhen në syllabus detyra apo punë të studentit, projekte, etj, përveç orëve të seminareve. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.



16. Në lidhje me komentin 16 të IAL për fushën 2, standardi 2.4, kriteri 2, IAL bën shpjegimin për shënimin e dhënë nga GVJ. Gjykimi në lidhje me këtë pikë i referohet konfuzionit të krijuar për studentin nga brendësia e syllabuseve të lëndëve të caktuara. Kjo do të thotë se, ku ka mbivendosje konceptesh, ashtu edhe strukturë të paqartë apo përsëritje të terminologjive në disa lëndë njëherësh, krijon paqartësi, konfuzion për studentët dhe ulje të sigurisë së përfuturit të dijeve nga ana e tyre. Theksojmë gjithashtu se çdo ndryshim apo reflektim i mundshëm për këto problematika është mirë t'i referohet dhe tërheqë edhe vlerësimet e studentëve. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

17. Në lidhje me komentin 17 të IAL për fushën 2, standardi 2.4, kriteri 3, gjykojmë pozitiv shpjegimin që bën IAL për secilën pikë që lidhet me përsëritjen e koncepteve, me mospërfshirjen e terminologjive të caktuara dhe vlerësimet në total kundrejt profilit të kësaj diplome, sikurse vlerësojmë dhe angazhimin për të ardhmen. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

18. Në lidhje me komentin 18 të IAL për fushën 2, standardi 2.4., kriteri 4, gjykojmë pozitiv vlerësimin e IAL për këto komente dhe sugjerojmë që të përfshihen dhe analizohen të gjithë elementët e diskutuar në këtë raport, përmirësimi i të cilave do të rrisë konkurrueshmërinë e këtij programi kundrejt si tregut kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtarizimit të kësaj diplome në të ardhmen. Ndërsa gjykojmë se emërtimi i programeve dhe/ose diplomave përkatëse është kusht i nevojshëm për t'u ndërkombëtarizuar. Për këtë është dhënë një orientim i përgjithshëm i prirjeve kryesore të emërtimit të diplomave të cilave IAL mund t'i referohet në të ardhmen. Kështu, GVJ gjykon që orientimi të bëhet drejt titujve si: "Menaxhim i turizmit", "Menaxhim i Sektorit të Mikpritjes", duke konsideruar që titulli/emërtimi i programit duhet të përputhet jo vetëm me brendësinë e programit (në sasi dhe cilësi të syllabuseve dhe njohurive të ofruara), por edhe me nevojat e tregut lokal (pra, për ato ndërmarrje turistike që janë më shume prezente në rajonin e Durrësit). Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

19. Në lidhje me komentin 19 për fushën 2, standardi 2.4, kriteri 6, GVJ gjykon se, në më së shumti literaturë të lëndëve, veçanërisht bazë, por edhe ato me zgjedhje, kanë literaturë të kahershme. Një diskutim i tillë është bërë edhe përgjatë vizitës në institucion. Sugjerojmë që në të ardhmen, edhe nëse literatura bazë do të mund të jetë relativisht e hershme, do të jetë efiçente përditësimi i saj me artikuj shkencorë apo botime (jo tekste) të viteve të fundit si nga autorë të njohur ndërkombëtarë të fushës, ashtu edhe vendas. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

20. Në lidhje me komentin 20 të IAL për fushën 2, standardi 2.4, kriteri 9, GVJ gjykon se, pavarësisht thellimit që mund të duan të bëjnë studentët në master shkencor, etj, masteri profesional është konceptuar i tillë që me njohuritë e veta të formëzojë studentët drejt tregut të punës, rrjedhimisht edhe njohuritë duhet të kenë një qasje më praktike, pra, më shumë drejt

tregut të punës. Nuk kemi gjetur ndonjë dokumentacion ku të thuhet se masteri profesional orienton studentët drejt masterit shkencor, prandaj edhe njohuritë brenda tij duhet të marrin në konsideratë këtë fakt. Së dyti, gjithashtu, shtojmë se do të jetë mirë që në të ardhmen departamenti të krahasojë dhe analizojë njohuritë që jep si niveli bachelor ashtu edhe master, pasi masteri nënkupton avancim, thellim dhe specializim të njohurive dhe jo përsëritje apo përplasje të terminologjive. Dhe së treti, sugjerojmë një profilizim më të madh të stafit drejt lëndëve që japin si dhe angazhim për të forcuar njohuritë për fushën dhe rritur kompetencat. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë. Lidhur me ndryshimin në Agjendë, dëshirojmë të risjellim në vëmendje se, sikurse është përmendur edhe në njoftimin që Ju është bërë në sistemin AMS, kjo ka ndodhur për shkak të një angazhimi të papritur. Megjithatë, GVJ, pranon komentin e bërë për këtë fjalë dhe heq shënimin përkatës në raport.

21. Në lidhje me komentin 21 të IAL për fushën 2, standardi 2.6., kriteri 1, teksa IAL mbështet pjesërisht vlerësimin e GVJ, përdor si argument për të kundërshtuar një pjesë të këtij standardi, faktin se studentët e diplomuar përbëjnë atë kategori që ka drejtuar pjesën dërrmuese të njësive akomoduese në Rajonin Tiranë. Kujtojmë se, RVJ, është për një program të caktuar studimi, çdo gjykim i referohet vetëm këtij programi, dokumentacionit, komenteve që rezultojnë nga takimet në institucion, etj. Në rast se një pjesë e studentëve të këtij programi do të kishin drejtuar ndërmarrjet turistike, kjo gjë do të duhej të ishte e dokumentuar dhe ndërkohë në asnjë dokumentacion dhe as nga vizita, nuk rezulton. Kjo do të thotë që ky argument që IAL ka paraqitur i referohet rolit të departamentit në përgjithësi. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

22. Në lidhje me komentin 22 të IAL për fushën 2, standardi 2.6., kriteri 3, GVJ gjykon se mungesa e komunikimit është e reflektuar direkt tek mos diplomimi i studentëve në sezonin e rregullt të korrikut, por në shtator. Për këtë arsye nuk mund të gjykojmë se stafi ka qenë i interesuar që të diplomohen studentët dhe i ka ndenjur pranë apo nxitur ato për të finalizuar studimet e tyre. Nuk vëmë në diskutim raportet e departamentit me bachelorin, apo profile të tjera, por është vendi të theksojmë se gjykimet i japim vetëm për këtë program studimi. Megjithatë, është pranuar nga GVJ ky argument dhe është hequr fjalia në raport, por sugjerohet fort që raporti dhe lidhjet me studentët të jenë përveçse për databazë, edhe një aset i informimit për të ardhmen i IAL për këtë program studimi.

23. Në lidhje me komentin 23 të IAL për fushën 2, standardit 2.6, kriterit 4, GVJ gjykon se, gjykimi i dhënë është i saktë dhe i bazuar në dokumentacion, por edhe i konfirmuar nga drejtuesit e institucionit në takimin në institucion. Kjo do të thotë se, për të përmbledhur dhe saktësuar, marrëveshjet janë në rang institucioni, por jo në nivel departamenti. Për këtë profil studentësh; nuk ka marrëveshje konkrete midis departamentit dhe ndërmarrjeve turistike apo njësive publike për këtë program studimi, që të përkthehen në praktika apo në shërbim të kësaj kategorie të studentëve. Është koha të mendojmë se si t'i shërbejmë nevojave lokale, për më tej atyre kombëtare. Gjykojmë që theksi dhe vëmendja të mbahet në këtë nivel. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

24. Në lidhje me komentin 24 të IAL për fushën 3, standardi 3.1, kriteri 1, GVJ gjykon se, vërtet që nga takimi me stafin vihen re përpjekje individuale të stafit për të përdorur metoda interaktive, përdorimin e videove, etj. (E cituar në standardin 3.2. kriteri 6), por ndërkohë nuk përmenden në mënyrë të shkruar format inovative të ndryshme në proces, si “të mësuarit përmes aktiviteteve (learning by doing)”, diskutimet dhe puna në grup e studentëve brenda orës së mësimit, etj. (Standardi 3.1, kriteri 1). Nuk ka udhëzues të veçantë në nivel institucional për metodat inovative në mësimdhënie. Neni 7 i rregullores për NJSBC udhëzon përdorimin e teknologjisë për vlerësimin e njohurive dhe dijeve, me synim eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit dhe rritjen e transparencës. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

25. Në lidhje me komentin 25 të IAL për fushën 3, standardi 3.2, kriteri 1, GVJ e gjykon të drejtë vlerësimin e dhënë në raport dhe riciton se: Në planet mësimore përcaktohen orët totale për çdo lëndë, por jo e ndarë sipas leksioneve dhe seminareve për çdo lëndë. Kjo krijon paqartësi në ndarjen dhe organizimin e mëtejshëm të programit të studimit. P.sh. në evidencën shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion (37) plani mësimor i programit të studimit, lënda e parë në tabelën e programit me përbërësit specifikë është “Metodat e kërkimit shkencor” ku përcaktohen 40 orë për leksione në auditor dhe 20 orë për veprimtari të tjera në auditor, supozohet seminare/laboratore, në këtë rast seminare. Duke qenë se semestri është 15 javë, kjo ndarje nuk arrin të përkthehet në një numër leksionesh dhe seminaresh në javë. Në tabelën e mëtejshme lënda ka 4 orë në javë. Nuk specifikohet se sa janë leksione dhe sa janë seminare. Nëse do të jenë 2 me 2 atëherë nuk qëndron shpërndarja 40 me 20 në orë totale, por do duhet të ishte 30 me 30. Nëse raporti leksione/seminare është 3/1 atëherë raporti i orëve totale leksion seminar do ishte 45/15. Pra, nuk ka përputhje midis deklarimit të raportit në orë ngarkese totale leksione/seminare. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

26. Në lidhje me komentin 26 të IAL për fushën 3, standardi 3.2, kriteri 2, GVJ gjykon se, përveç sqarimit të mënyrave apo rasteve të trajtimit të seminareve, nuk shihet nxitja e formave ndërvepruese me studentin apo informacion më i detajuar mbi detyrat e kursit, apo vlerësimin e seminareve, çfarë do të përfshijnë detyrat apo projektet, etj. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

27. Në lidhje me komentin 27 të IAL për fushën 3, standardi 3.2, kriteri 3, GVJ gjykon se, përveçse përpjekjet po fillojnë të bëhen dhe janë për t’u vlerësuar, por janë ende në nivele institucionale. Në fakt, bëhet fjalë si për trajnime apo guida për rritjen e njohurive mbi metodat e reja në mësimdhënie dhe edukim, në arsimin e lartë, apo forma të tjera diskutimesh dhe debatesh brenda departamentit, forma të komunikimit me aktorët jashtë departamentit, alumni, apo dhe studentët aktualë për të identifikuar metodat më të mira dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

28. Në lidhje me komentin 27 të IAL për fushën 3, standardi 3.2, kriteri 7, GVJ gjykon se nuk mund të bëhen komente për këtë pikë, pasi vetë IAL konfirmon mospjesëmarrjen aktive të asaj kategorie të studentëve në takim, që vërtet është përfaqësuese dhe i përket këtij profili studimi. Sikurse është shprehur edhe më lart, GVJ, dëshiron të risjellë në vëmendje se, ndryshimi në Agjendë, sikurse është përmendur edhe në njoftimin që Ju është bërë në sistemin AMS, ka ndodhur për shkak të një angazhimi të papritur. Megjithatë reflektimi për këte argument është si më poshtë:

Fjalja nga: *“Nuk mund të flasim konkretisht për efektin e formave të mësimdhënies tek studentët, pasi nuk patëm një përfaqësim të kënaqshëm të studentëve të programit; si nga viti i kaluar edhe nga viti aktual, patëm prezent në takim vetëm nga një student, për vitin e kaluar akademik dhe për vitin aktual akademik”*, ndryshon ne: *“Nuk mund të flasim konkretisht për efektin e formave të mësimdhënies tek studentët, pasi nuk patëm një përfaqësim të kënaqshëm të studentëve të programit”*.

29. Në lidhje me komentin 29 të IAL për fushën 3, standardi 3.3, kriteri 5 dhe 6, GVJ gjykon se, gjykimi dhe vlerësimi i këtij programi studimi është bazuar në dy shtylla kryesore informacioni: dokumentacioni dhe vizita në institucion. Konsiderohet mjaft i rëndësishëm takimi me stafin dhe fakti që stafi është relativisht i vogël, merr edhe më shumë rëndësi informacioni i komunikuar nga secili individ. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

30. Në lidhje me komentin 30 të IAL për fushën 3, standardi 3.3, kriteri 10, GVJ nuk gjykon se ka ndryshim të asaj çka është konkluduar nga takimi me stafin dhe diskutimi i tyre, që sikurse u tha edhe më lart, përbën një numër të vogël staf, të përfshirë në mësimdhënien e këtij masteri. Edhe njëherë citojmë se: ka një rregullore të tezës së diplomës për masterat e nivelit të dytë në UAMD duke përfshirë dhe MP DNT. Neni 3 jep përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor duke përmbushur detyrimet për mbështetjen, orientimin dhe asistimin në procesin e diplomimit përmes temës së diplomës. Megjithatë nga vizita në institucion (takimi me stafin akademik), stafi shprehet se jo gjithnjë tema e diplomës është zgjedhja më e mirë për diplomimin, ata do të donin që kjo të ndryshonte në varësi të nxjerrjes së një produkti cilësor lidhur me temën e diplomës. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

31. Në lidhje me komentin 31 të IAL për fushën 3, standardi 3.4, kriteri 3, GVJ gjykon se, gjykimi i bërë prej saj është bërë mbi dokumentacionin si dhe diskutimet me stafin dhe studentët. Pra, pranimi dhe përpjekja për të zbatuar metodat e reja, është hapi i parë, por më shumë duhet bërë për të nxitur eksperimentimin, që do të thotë proaktivitet në procesin e inovacionit në mësimdhënie. Në këtë rast do të ishte me vend që këto aspekte jo vetëm të përfshiheshin në strategjitë përkatëse, por edhe të punohej për zbatimin e metodave alternative, së pari duke identifikuar praktikat ndërkombëtare në këtë drejtim, e më pas duke planifikuar zbatimin dhe pasqyruar në çdo syllabus. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

32. Në lidhje me komentin 32 të IAL për fushën 3, standardi 3.4, kriteri 4, vlerësojmë dakordësimin e pjesshëm të IAL, por ritheksohet se, bazuar edhe në diskutimet me stafin apo evidencat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion për vlerësim, ka përpjekje për trajnime dhe kualifikime në fushën e turizmit gjatë kohëve të fundit si dhe pjesëmarrje në projekte, por ka një qasje në disa raste jo të duhur lidhur me kërkimin shkencor, ku një pedagog ka artikuj në fusha krejt të ndryshme si fusha shëndetësore, të palidhura me turizmin, por nga ana tjetër edhe artikujt për turizmin janë në një linjë krejt të ndryshme. Sigurisht, fusha të lidhura mund të gjenden edhe në turizëm, lidhur me mjedisin, por ideja themelore e këtij masteri është drejtimi i ndërmarrjeve turistike, prandaj edhe kualifikimet e mëtejshme dhe kërkimi shkencor duhet të përqendrohet në këto fusha për të qenë më afër lëndëve dhe mësimdhënies në këtë master. Gjithashtu, ka edhe pedagogë të cilët nuk kanë bërë kualifikime dhe bazojnë mësimdhënien në eksperiencën profesionale, e cila vlerësohet nga studentët, por nga ana tjetër nuk krijon kushte për kualifikim dhe zhvillim të mëtejshëm të diplomës. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

33. Në lidhje me komentin 33 të IAL për fushën 3, standardi 3.6 (cituar gabim nga IAL si standardi 3.5), kriteri 1, GVJ gjykon të drejtë atë çka është thënë në RVJ, ku testimi i dijeve dhe njohurive do të ishte më i mirëreflektuar në vlerësimin përfundimtar me një peshë më të lartë, kështu do të mund gjithashtu të testoheshin më tepër aftësi, si psh. aftësi të analizave të rasteve, aftësi për prezantime dhe vlerësime të situatave, aftësi të punës në grup dhe komunikimit, të cilat nuk mund të vlerësohen vetëm përmes provimit përfundimtar. Përfshirja e kategorisë së seminareve përveç detyrave do të ishte në këtë rast më produktive. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

34. Në lidhje me komentin 34 të IAL për fushën 3, standardi 3.5, kriteri 2, GVJ, gjykon pozitiv dhe mbështetës argumentimin e dhënë nga IAL për këtë shënim, i cili lidhet me faktin se ka kaluar vetëm një vit nga hapja e këtij programi që justifikon mospasjen e formave elektronike të vlerësimit.

35. Në lidhje me komentin 35 të IAL për fushën 3, standardi 3.7, kriteri 5, GVJ ribën argumentimin por bazuar në punën e fakultetit. Kujtojmë dhe theksojmë se gjykimi i GVJ është bërë për këtë program studimi dhe është bazuar jo vetëm në dokumentacion, por veçanërisht nga konsultimi me studentët dhe më tej me stafin. Ose mund të jenë realizuar orë studimi, por jo nga ndërmarrje turistike. Theksojmë se është e rëndësishme të mbahet parasysh profili i diplomës që përcakton targetin kryesor të njohurive që duhet të përftojë studentët. Diploma, njohuritë dhe dijet duhet të furnizojnë studentët që ti mirëshërbejnë sektorit të ndërmarrjeve turistike. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

36. Në lidhje me komentin 36 të IAL për fushën 3, standardi 3.7, kriteri 7, GVJ gjykon se, gjykimi në këtë pikë është bazuar në vizitën në institucion nga takimi me stafin. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

37. Në lidhje me komentin 37 të IAL për fushën 3, standardi 3.7, kriteri 8, GVJ gjykon se, gjykimi për këtë pikë në fakt përcillet përmes komenteve të mësipërme të bëra nga GVJ në pothuajse të gjitha pikat e mësipërme (për të mos përsëritur). Ky koment qëndron në formën e një identifikimi dhe sugjerimi për përmirësim në të ardhmen për të rritur efikasitetin e punës midis stafit në shërbim të studentëve dhe përcjelljes së dijeve. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

38. Në lidhje me komentin 38 të IAL për fushën 3, standardi 3.9, kriteri 4 dhe 5, GVJ gjykon se, gjykimi i bërë prej saj është bazuar në dokumentacion lidhur me rregulloren e diplomës dhe të diplomimit. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

39. Lidhur me komentin 39 të IAL për fushën 4, standardi 4.1, kriteri 3, gjykimi është bërë nga vizita konkrete në institucion me njësinë përfaqësuese dhe nga dokumentacioni i ballafaquar. Më saktë citohet në raport se: kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kriterëve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan departamenti sipas nevojave të tij për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Kriteret e përgjithshme janë të vendosura në evidencën 110. Për pjesën tjetër, GVJ dakordëson dhe heq nga raporti, fjalinë: “Dokumenti nuk paraqet kriteret specifike apo raste kur mund të ketë kriteret specifike” si dhe shton: “Në dokumentin “Memo kriteret për PAK për vitin akademik 2019-2020”, IAL, ka paraqitur kriteret specifike të vendosura nga departamenti për stafin PAK, për këtë vit akademik”.

40. Në lidhje me komentin 40 të IAL për fushën 4, standardi 4.1, kriteri 4, GVJ, gjykon reflekton në raport ndryshimin si më poshtë: Hiqet pjesa e fjalisë “por nuk ka fakte për këtë” dhe shtohet fjalia: “Në dokumentin “Memo kriteret për PAK për vitin akademik 2019-2020”, IAL, ka paraqitur kriteret specifike të vendosura nga departamenti për stafin PAK, për këtë vit akademik”. Në fakt ka mungesë aktualisht të stafëve të diplomuara në degën e turizmit si PAE ashtu edhe PAK.

Gjithashtu, në vijim të pikave 39 dhe 40 si më lart, vlerësimi për standardin IV.1 ndryshon nga “Përbushet kryesisht” në “Përbushet plotësisht”.

41. Në lidhje me komentin 41 të IAL për fushën 4, standardi 4.2, kriteri 3, GVJ gjykon se nuk ka programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies, të cilat të ofrohen në mënyrë zyrtare nga institucioni, apo të ketë bashkëpunime të institucionit në këtë kuadër. GVJ sugjeron fort që kjo të përmirësohet në të ardhmen, që të mos lihet thjesht në kuadër të dëshirës apo nevojës që vetë stafi ndjen për të përdorur metoda inovative dhe teknologji, por të punohet me sistemet e-learning, me metodat bashkëvepruese, etj. Ky gjykim është bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga institucioni. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

42. Në lidhje me komentin 42 të IAL për fushën 4, standardi 4.4, kriteri 2, GVJ gjykon se citimi lidhet me: “titujt shqip për programin e studimit janë të kufizuar, megjithëse ka një numër të titujve në shqip që janë botuar në të kaluarën”. Gjykimi është dhënë bazuar në vizitën në institucion dhe takimet me stafin. Por, aktualisht, programi duhet të fokusohet sidomos në titujt në shqip për lëndët karakterizuese dhe lëndët bazë, për të cilat mund të bashkëpunohet për përkthimin në programin Cleanscore. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

43. Në lidhje me komentin 43 të IAL për fushën 4, standardi 4.4, kriteri 5, GVJ, gjykon se, edhe nga vizita në institucion, nga komunikimi me stafin, rezulton se ka një mungesë të përcjelljes së nevojave të stafit për literaturë. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

44. Në lidhje me komentin 44 të IAL për fushën 4, standardi 4.5, kriteri 3 dhe 4, GVJ gjykon se, nisur nga vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve, është konkluduar se nuk është prezente ekzistenca e një sistemi të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili të mundësojë qarkullimin dhe përcjelljen e informacionit midis personelit, apo pasjen e një aksesit të dedikuar në informacione e dokumente për personelin, studentët etj. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

45. Në lidhje me komentin 45 të IAL për fushën 4, standardi 4.6, kriteri 1, 2 dhe 5, GVJ gjykon se, të gjitha gjykimet e paraqitura janë bazuar në dokumentacionin që bashkëshoqëron çdo kriter. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

46. Në lidhje me komentin 46 të IAL për fushën 6, standardi 6.3, kriteri 1, vlerësimi i dhënë nga GVJ orienton në të ardhmen përdorimin dhe vlerësimin periodik të brendshëm të programeve të studimit. Orintimi është sugjerues, sidomos në kuadrin e pasjes dhe identifikimit të problematikave që rezultuan nga ky raportim. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

47. Në lidhje me komentin 47 të IAL për fushën 6, standardi 6.4, kriteri 1, vlerësohet përkushtimi i departamentit por, përse kohë që pranohet mungesa e stafit të kualifikuar nga vetë departamenti, qasja me aktorët e jashtëm do të ishte më efiçente në këto momente të rritjes. Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk duhet të jenë thjesht letra të firmosura, ndërmarrjet turistike kanë mungesa të theksuara konsultimi, shërbimi, dijesh, etj, që do të thotë se departamenti i turizmit duhet të shërbejë si një njësi cilësore dhe veçanërisht inovative në qasje të reja të marketingut, teknologjisë, sipërmarrjes, etj. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

48. Në lidhje me komentin 48 të IAL për fushën 4, standardi 6.4, kriteri 5, GVJ, gjykon se është bazuar në dokumentacion dhe diskutimet me grupet e ndryshme përgjatë vizitës në

institucion. Referimi i bëhet një rrjeti të gjerë aktorësh të jashtëm që lidhen që me praktikat mësimore (ndërmarrje turistike brenda rajonit të Durrësit), bashkëpunimet shkencore me ndërmarrje turistike të Rajonit të Durrësit, etj. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.

49. Në lidhje me komentin 49 të IAL për fushën 6, standardi 6.5, kriteri 5, GVJ gjykon se, kjo u konkludua edhe nga takimi me studentët të cilët shpesh konfirmojnë edhe saktësinë e brendësisë së dokumentacionit bashkëshoqërues të vënë në dispozicion nga institucioni. Dhe nga ana tjetër, nuk vihet re nga diskutimi me ta se janë të përfshirë në përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë. Sa më lart, vlerësimi për këtë pikë mbetet i njëjtë.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me interesat kombëtare. Kështu, Statuti, në nenin 2 dhe 3 thekson misionin dhe vizionin e UAMD për të nxitur dhe mbështetur formimin e specialistëve dhe shkencëtarëve të rinj. Edhe në planin strategjik theksohet sidomos krijimi i nje kulture akademike e cila synon përgatitjen e shëndoshë të studentëve për një mjedis konkurrues, jo vetem në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Gjithashtu, i jepet rëndësi ekselencës në mësimdhënie-nxënie, duke integruar njohuritë konceptuale dhe praktike ndërmjet disiplinave të ndryshme dhe botës akademike-biznesit. Këto janë në përputhje me interesat kombëtare për të krijuar specialistë në fusha të ndryshme, por edhe nevojën kombëtare për kërkues shkencorë, për mësimdhënie cilësore në hapësirën e Arsimit të Lartë.</p> <p>Evidencat e përputhshmërisë me interesat kombëtare gjenden jo vetëm në dokumentacionin e institucionit, por edhe të fakultetit dhe rregulloret e departamentit.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD, neni, 2, 3, 4.</i> <i>Evidenca 3, Plani strategjik, fq. 22, 23.</i> <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit, fq. 4.</i> <i>Evidenca 5, Rregullore e Universitetit.</i></p>
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Megjithëse është program relativisht i ri, ky program përpiket të krijojë, nxisë dhe mbështesë një kulturë akademike të besueshme, që sigurohet përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti të reflektuar si brenda departamentit, midis studentëve apo me biznesin.</p> <p>Ky reflektim vjen nga konsultimi me dokumentat strategjike të institucionit, por edhe departamentit, si në vijim:</p>

	<p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD, neni, 2, 3, 4.</i>  <i>Evidenca 3, Plani strategjik, fq. 22, 23.</i>  <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit, fq. 4.</i>  <i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit, në të gjitha dokumentat bashkëngjitur, reflekton praninë e të gjitha objektivave të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Këto qëllime dhe objektiva janë në përputhje me qëllimin dhe misionin e IAL dhe detajojnë në mënyrë specifike fushën përkatëse të turizmit, si fushë specializimi të profesionistëve, si edhe tregun e punës që i përgjigjen specialistët e dalë në përfundim të këtij programi. Sipas dokumentacionit, ai synon pajisjen me njohuritë të nevojshme.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i>  <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit, fq. 7, fq. 8.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Pavarësisht përpjekjes së institucionit që përmes këtij programi studimi të përafrojë nevojat lokale me potencialet njerëzore të ofruara përmes këtij masteri, gjykojmë se institucioni mund të bëjë një përpjekje më të madhe për të përafuar më shumë dhe përdorur më mirë burimet njerëzore lokale (studentët) me nevojat në rritje që tregu lokal, përpos atij kombëtar, ka për njohuri, aftësi dhe dije në fushën e turizmit, veçanërisht në atë të menaxhimit të ndërmarrjeve turistike. Si përpjekje e parë gjykohet pozitive synimi për të përafuar qëllimet dhe objektivat e këtij programi me strategjitë dhe dokumentacionin bazë të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Plani i zhvillimit strategjik, 2016-2020, i realizuar në vitin 2017, miratuar me Vendimin Nr. 11, datë 31.03.2017, përcakton prioritetet strategjike të UAMD, të temave dhe sektorëve strategjikë që merr përsipër të orientojë me programet e veta të studimit. Përderisa dokumentat strategjikë të departamentit të turizmit, i cili merr përsipër realizimin e këtij programi studimi, nuk i paraprijnë programit të studimit në kohë, por ose janë në kohë paralele ose janë hapur dhe hyrë në fuqi pas programit, vështirësojnë sigurimin se programi i studimit të jetë hartuar në bazë të rregulloreve të departamentit apo dokumentave të tjera strategjike të tij. Sigurisht që politikat, planet dhe strategjitë e institucionit të UAMD janë mjaft të rëndësishme dhe specifike, por programet e veçanta të studimit kanë nevojë për udhëheqje përmes paraprirjes me dokumenta si rregullore të departamentit, plane marketing të departamentit, apo rregullore e funksionimit të programit aktual të studimit. Të gjitha këto dokumenta që lidhen dhe ndikojnë direkt në cilësinë e realizimit të këtij programi studimi kanë hyrë në fuqi dhe miratuar në kohën kur studentët e këtij programi duhej të diplomoheshin, qershor 2019.</p> <p><i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i FB.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 4.1, Plani strategjik i departamentit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Përsa i përket çështjeve të emërtimit dhe përputhshmërisë së tij me fushat e drejtimit akademik të institucionit, duhet të thuhet se në vetvete struktura dhe emërtimi në anglisht i programit kanë probleme dhe nevojë për t'u riorganizuar. Bazuar në dokumentacionin, konsultimin dhe diskutimet me të gjithë grupet e interesit në institucion, që nga departamenti dhe deri tek drejtuesi i njësisë së sigurimit të cilësisë, i cili njëkohësisht është edhe pjesë mjaft aktive e grupit të vlerësimit të brendshëm, rezulton se emërtimi në gjuhën angleze i diplomës që pajiset studenti nuk është i duhuri, sikurse edhe nuk është i përafëruar me atë çka ofrojnë diploma të tjera të ngjashme në botë. Kështu, titulli i diplomes “Drejtimit i Ndërmarrjeve Turistike” duhet të përkthehet në “Tourism Enterprises Management” në vend të “Tourist Enterprises Direction”. Një përkufizim i tillë vështirëson njohjen në nivele ndërkombëtare, nëse do i duhet ta konvertojë studenti. Nga konsultimet me drejtuesit jashtë njësisë bazë të departamentit, rezulton se kështu ka ardhur nga departamenti.</p> <p><i>Evidenca 15, Model diplome.</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Dokumentacioni bazë i vënë në dispozicion nga institucioni tregon dhe qartëson se UAMD synon qartazi të ofrojë programe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Por, mungesa e nje studimi tregu, para apo pas diplomimit, apo mos pasja e raporteve të përmbledhura në formën e analizave pas diskutimeve me drejtuesit e bizneseve lokale të konsideruara si kërkime cilësore apo fokus grupe që të përafrojnë dhe justifikojnë nevojën e një diplome të tillë të paktën në kushtet e mungesës së studimit të tregut, kanë vështirësuar mundësimin që ky program studimi të mund të zhvillohet me nevojat lokale apo trendet globale. Nëse do ishin konsultuar nevojat lokale, strukturimi brenda programit do të duhej të ishte ndryshe, marrëdhëniet dhe raportet me aktorët e biznesit të konsideruar si ndërmarrje turistike do të ishin efçente, përfituese veçanërisht për studentët, të mirëdokumentuara, si do ti kishin shërbyer edhe rritjes së numrit të studentëve të vitit pasardhës për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 3, Plani strategjik i UAMD.</i>  <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi I.3</b>  <b>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Sigurisht që qëllimi i këtij programi është të përafrojë formimin e studentëve me tregun e punës, të forcojë dijet dhe kompetencat profesionale. Kjo gjë rezulton nga dokumentat kryesorë strategjikë të departamentit, si dhe nga vizita në institucion (<i>takimet me stafin, përgjegjësin e departamentit</i>).</p> <p><i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i FB.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 4.1, Plani strategjik i departamentit.</i>  <i>Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i>  <i>Vizita në IAL, Takimet me Përgjegjësin e Departamentit dhe Stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion dy dokumenta të konsideruar</p>

<p>mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>si studime tregu para dhe pas diplomimit, por pas konsultimit me këtë dokumentacion, por edhe pas diskutimit nga vizita në institucion si me grupin e vlerësimit të brendshëm ashtu edhe me drejtuesit e departamentit dhe të fakultetit, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Është paraqitur si studim tregu një dokument i cili i është drejtuar ministrisë përgjegjëse për arsimin si kërkesë për hapjen e këtij programi;</li> <li>• Nuk ka studim tregu pas diplomimit që të ofrojë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</li> </ul> <p>Institucioni nuk ka kryer studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve apo dhe në mënyrë periodike. Nuk ka të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, përputhje të kërkesave dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. Njësia bazë e departamentit, stafi, dhe njësitë e tjera të kërkimit shkencor janë të ndërgjegjshëm se ndërmarrjet turistike (operatorët turistikë, hotelet dhe strukturat e tjera të akomodimit apo mikpritjes), janë të shumta në numër mbi 700, dhe se mundësitë e zhvillimit të këtij programi në të ardhmen do të jenë të mëdha, duke përbërë potencial për të gjithë universitetin. Por nuk ka statistika dhe dokumentacion që të vërtetojë se këto studentë, të këtij programi studimi që akreditohet, të kenë kryer praktikën pranë ndërmarrjeve lokale turistike, apo të jenë punësuar tashmë pas mbylljes së studimeve në këto njësi turistike.</p> <p>Ka kontrata bashkëpunimi të bashkëngjitura si dokumentacion, por nuk ka rezultate efçente të këtyre kontratave, nuk ka psh. statistika që tregojnë se kontrata me Harmonia Group ka prodhuar punësim, ka plotësuar kërkesën e tyre dhe ka nxitur më tej bashkëpunimin mes institucioneve përkatëse, dhe të ketë rezultuar me rritje kërkesë nga kjo ndërmarrje turistike. I gjithë ky argument rrjedhon si nga konsultimet me dokumentacionin, ashtu edhe nga takimet në institucion me studentë të programit të studimit, nga stafi i këtij programi studimi apo drejtuesi i departamentit, sikurse edhe nga njësitë e marrëveshjeve</p>
---	---

	<p>institucionale që u kontaktuan në vizitën dy ditore në UAMD.</p> <p><i>Evidenca 16, Studimi i tregut para hapjes së programit MP DNT.</i>  <i>Evidenca 17, Studim për tregun e punës, pas daljes së studentëve.</i>  <i>Evidenca 34, Marëveshje bashkpunimi të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 34.1, Tabelë përmbledhëse me institucione bashkëpunuese UAMD.</i>  <i>Evidenca 34.2, MoU UAMD.</i>  <i>Vizita në IAL, takimet me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, GVB, stafin akademik, studentët, sektorin e planifikimit dhe monitorimit të projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin rezultojnë se objektivat që ky program synon të realizojë e plotësojë të jenë në përputhje me objektivat e përgjithshme të UAMD si dhe prirjet ndërkombëtare të zhvillimit të sektorit përkatës.</p> <p>Po kështu, bazuar në dokumentacionin (<i>struktura e programit të studimit, lëndët, syllabuset, stafin dhe përputhshmëria e tij me lëndët</i>) por edhe pas ballafaqimit në vizitën dy ditore në UAMD të problematikave të konsultuara me dokumentacionin, rezultojnë se: struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve jo plotësisht garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Mungesa e një studimi tregu ka vështirësuar ofrimin e lëndëve, njohurive dhe syllabuseve përkatëse të duhura për tregun. Brenda programit ka probleme të strukturës dhe përmbajtjes që nuk kontribuojnë në formimin me njohuri dhe aftësim të studentëve, siç janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e lëndëve me zgjedhje;</li> <li>Lëndët që nuk i nevojiten këtij programi studimi, si “Metoda kërkimi në turizëm”, që përveçse nuk i duhet këtij programi studimi (pasi është master profesional dhe jo shkencor), zhvillohet nga pedagog me kontratë jo adapt për ta ofruar, për shkak të mospërputhjes me fushën kryesore ku synohet të ofrohen specialistë, atë të turizmit dhe zhvillohet në semestrin e dytë;</li> <li>Përmbajtja e syllabuseve, ku koncepte bazë dhe të rëndësishme trajtohen shpesh brenda lëndëve të ndryshme duke krijuar konfuzion njohurish tek studentët.</li> <li>Një përmbajtje jo të bazuar në titullin e lëndës por të përgjithshme dhe jo të thelluar.</li> </ol>

	<p>Sa më lart, GVJ rekomandon si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Është urgjente ofrimi dhe larmishmëria e lëndëve me zgjedhje;</li> <li>• Kujdesja që të mos ketë përplasje të koncepteve dhe brendësisë së syllabuseve;</li> <li>• Është e nevojshme futja dhe përfshirja e atyre lëndëve dhe moduleve që plotësojnë mungesën e tregut me aftësi, njohuri dhe kompetenca të tregut;</li> <li>• Orientimi i diplomave drejt nevojave të operatorëve dhe ndërmarrjeve turistike;</li> <li>• Përfshirja dhe qendërzimi i studentëve në këtë proces;</li> <li>• Identifikimi i asaj pjese të stafit që orientohet drejt kërkimit dhe përfshirja cilësore e tyre në këtë proces.</li> </ul> <p>Ky program studimi ka nevojë për përmirësime cilësore të strukturës së programit, përmbajtjes së çdo syllabusi, sigurimit të mos përplasjes së koncepteve, konsultimit me ekspertë të fushës, akademikë, drejtues të ndërmarrjeve turistike të zonës, pra me të gjithë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në zinxhirin e vlerës. Ka nevojë për të tërhequr dhe reflektuar feedback të studentëve dhe stafit mësimdhënës, të përballjes dhe diskutimeve përftuese që rezultojnë dhe të një përjasjeje sa më optimale të çdo rezultatit në programin e ardhshëm të këtij masteri.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>  <i>Vizitë në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, veçanërisht në diskutimet intensive me drejtuesin e departamentit, del në pah përpjekja për të ofruar programe studimi cilësore, të ngjashme me nivelet ndërkombëtare, sikurse edhe pranohen vështirësitë e këtij programi i cili sapo ka prodhuar studentet e parë të diplomuar (11 studentë).</p> <p><i>Evidenca 27, Ecuria e studentëve.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat</p>	<p>Programi i studimit ka synuar të hartohet në përputhje me</p>

<p>e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. Të paktën dokumentacionet përpiqen të mbështesin këtë qasje. Por diskutimet me stafin, drejtuesit, studentët dhe të gjithë aktorët e përfshirë përgjatë vizitës dy ditore në UAMD rezultojnë se ende kërkohet më shumë punë për të siguruar vërtet një përjasje efiçente me nevojat lokale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 7, Rregullore e programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 58, Programe të ngjashme të Drejtimit të ndërmarrjeve.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin e programit të studimit, takimi me studentët, takimi me zyrën e kurrikulave dhe studentëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ka përpjekje nga departamenti për të trajtuar këtë element të formimit të studentëve në mënyrë cilësore dhe në përputhje me direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Por aktivitetet që lidhen jo vetëm me praktikën dhe realizimin e saj, por edhe aktivitetet e tjera mbështetëse të formimit të studentëve nuk lidhen dhe i referohen kryesisht ndërmarrjeve turistike.</p> <p><i>Evidenca 10.3, Rregullore e praktikës.</i>  <i>Evidenca 34, Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Sikurse pranohet edhe nga njësia e sigurimit të cilësisë, pasja e të gjithë elementeve të duhura në format dhe përmbajtje brenda strukturës së këtij programi studimi, do të mundësojë një qasje më pozitive dhe të sigurtë në të ardhmen për të bërë më të përshtatshme diplomën edhe përmes konvertimeve të mëtejshme në varësi të thellimit të njohurive, përfundimit të aftësive profesionale më tej nga studentët e këtij programi studimi, apo për tërheqjen e studentëve të huaj drejt këtij program studimi.</p> <p>Për t’i shërbyer qëllimit të thithjes së studentëve të huaj, është e nevojshme dhe emergjente ndryshimi i titullit të diplomës në përkthimin dhe përshtatjen që i është bërë në gjuhën angleze.</p> <p><i>Evidenca 15, Model diplome.</i>  <i>Evidenca 15.1, Suplement diplome.</i>  <i>Evidenca 58, Programe të ngjashme të Drejtimit të ndërmarrjeve.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë</p>	<p>Sigurisht që programet e studimit mund të hapen përkohësisht,</p>



<p>“Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>por për të siguruar efikasitetin dhe cilësinë e njohurive të përfuara për të gjitha kategoritë dhe tregjet e synuara që kanë këtë nevojë, është thelbësisht e rekomandueshme ndryshimi dhe reflektimi i të gjithë elementëve të përmendur më lart dhe në vijim të këtij raporti në lidhje me elementët e strukturës dhe përmbajtjes të munguara në këtë program studimi. Në këtë mënyrë sigurohemi që përcillet njohuria e duhur, dija është efiçente dhe përcjellja është bërë nga staf cilësor.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Infrastruktura për studentët dhe stafin, zhvillimin e mësimin, biblioteka dhe njësitë e tjera të vëna në dispozicion përbëjnë burime dhe kapacitete të konsiderueshme që mbështesin zhvillimin e mësimin për një numër shumë herë më të madh të studentëve si dhe krijojnë bazën për fuqizimin e departamentit dhe mbështetjen e pedagogëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Nga ana tjetër, lokaliteti dhe pozicioni gjeografik i UAMD krijojnë një pikë kyçe strategjike të vendosur midis një shtrirje të gjerë të ndërmarrjeve turistike, e bën që departamenti që ofron këtë program studimi të shërbejë si laborator në vetvete për të ofruar lëndën e parë (studentët) për tregun lokal.</p> <p>Lokaliteti dhe afërsia me bizneset krijojnë idenë se UAMD është vendosur në një pozicion tipik laboratorik. Pra, UAMD, me këtë qasje territoriale për afroon kërkesën me ofertën.</p> <p>Në këtë mënyrë bëhet i mundur sigurimi i një shërbimi efiçent ndaj tregut që përbën gjithashtu përmbushjen e një prej qëllimeve më kryesore të funksionimit të IAL.</p> <p>Në lidhje me burimet akademike që mbështesin dhe sigurojnë një cilësi mësimdhënie dhe garantojnë ofrimin e njohurive të duhura, mund të gjykohej se nga konsultimi me dokumentacionin, CV dhe përputhjen e stafit me modulet përkatëse, nuk është bërë një përputhje cilësore e formimit bazë të çdo pedagogu me lëndën në këtë program studimi.</p>

	<p>UAMD, përmes departamentit duhet të orientojë më fort kërkimin shkencor të pedagogëve sipas fushës që mbulojnë, modulit që zhvillojnë për të mbuluar mungesën e njohurive që ia jep formimi bazë në doktoraturë. Kështu p.sh nëse një pedagog jep një lëndë në sektorin e hotelerisë por doktoraturën e ka në tjetër fushë, atëherë do i duhet të orientojë jo vetëm kërkimin e tij, por edhe kualifikimin dhe specializimin e tij, si edhe diplomat e studentëve që udhëheq në këtë fushë.</p> <p>Po kështu, shpërndarja e ngarkesës mësimore në staf me kontratë duhet të synojë të rrisë dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies. Departamenti si njësi bazë dhe ekzekutive duhet të synojë të përafrojë në programe të tilla studimi ekspertë të fushës që përveç viteve dhe eksperiencës, të sigurohet ofrimi i njohurive të duhura, jo të përgjithshme, por të përshtatura fushës. Në këtë mënyrë, programe të tilla studimi, që nuk janë ndërdisiplinore duhet të sigurojnë thellimin e njohurive brenda konceptimit të ndërmarrjeve turistike.</p> <p><i>Evidenca 20, CV e stafit.</i>  <i>Evidenca 25, Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik për programin e studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 42, Të dhëna për Infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, ngarkesa PAE dhe PAK për sem I-rë dhe parashikimi për sem II-të, v.a 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program studimi është në profilin e institucionit të UAMD, madje ofrimi i tij përbën një mundësi për rritje cilësore jo vetëm të departamentit, por edhe të fakultetit dhe universitetit. Tregu i punës ka nevojë për këtë kategori të studentëve dhe kjo duhet të shërbejë si shtysë për hove cilësore të të gjithë aktorëve, një shtysë më shumë për një përkushtim cilësor dhe totalisht mbështetës kundrejt studentëve.</p> <p><i>Evidenca 3, Plani strategjik i UAMD.</i>  <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 4, Plani strategjik i programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ka një qasje aktive të njësive të tjera të funksionimit brenda universitetit në mbështetje të funksionimit të departamentit që ofron këtë program studimi. Nga takimi në institucion me drejtuesit e zyrës së karrierës, alumni, zyra e sigurimit të cilësisë apo ajo e mbështetjes akademike, rezulton se këto zyra sado që janë kryesisht të reja funksionojnë dhe përpiqen cilësisht për të mbështetur të gjithë institucionin, dhe sigurisht brenda kornizës së komunikimit mbështesin dhe departamentin e turizmit. Këtë e bëjnë kryesisht përmes njoftimeve përmes departamentit për çdo lloj aplikimi, kërkimi shkencor të mundshëm, aktiviteti që prek direkt apo indirekt interesin e stafit të këtij departamenti, madje duke sjellë edhe një person përgjegjës të kësaj zyre pranë fakultetit për të rritur prezencën dhe mbështetur nevojën që mund të kenë stafi dhe studentët. Planet e kësaj zyre për të ardhmen janë sfiduese dhe synojnë të rrisin cilësinë. Kjo u përcoll veçanërisht me vizitën në institucion.</p> <p>Raporti analitik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit Master Profesional në “Drejtimit i Ndërmarrjeve Turistike” tregon partnerët dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, partneritete me institucione brenda vendit, si dhe me ato jashtë vendit. Por ndërkohë për mbikëqyrjen e programit të studimit nuk bëhet një shpërndarje efiçente e burimeve njerëzore brenda njësisë bazë, që fillon me mos ndarjen e informacionit midis të gjithë anëtarëve, me mos përfshirjen e studentëve në këto procese dhe mos delegimin e përfshirjen aktive të personalizuar të detyrave, përgjegjësiive dhe veçanërisht motivimeve brenda njësisë.</p> <p><i>Evidenca 35, Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit DT. Vizita në IAL, takimi me drejtuesit e zyrës së karrierës, alumni, zyra e sigurimit të cilësisë apo ajo e mbështetjes akademike.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e</p>	<p>Bashkëpunimi midis departamenteve të ndryshme të turizmit me IAL në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerëzore.</p> <p>Por rezulton si nga dokumentacioni ashtu edhe nga vizita në</p>

<p>biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>terren se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me departamente të ndryshme në IAL të tjera në vend;</li> <li>2. Ka mungesë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me qytetin e Tiranës për profilin dhe programin që ofron ky department;</li> <li>3. Nuk ka realizim dhe konkretizim me përfitimin veçanërisht të studentëve e pastaj të departamentit të marrëveshjeve konkrete. Kështu p.sh., edhe pse ka një marrëveshje me Harmonia Group si ndërmarrje turistike, nuk rezulton asnjë student i programit të ketë kryer praktikë mësimore në këtë institucion. Por vërehet orientimi i studentëve me praktika të ndryshme apo leksione informuese në ndërmarrje jo me karakter apo përafrim të drejtimit të programit;</li> <li>4. Nuk ka një analizë apo qasje të politikës proaktive të Universitetit për mbështetjen e këtij programi;</li> <li>5. Departamenti shpesh i referohet ekzistencës së marrëveshjeve që ka Universiteti apo Fakulteti me të tretët, dhe jo ato që janë prodhuar nga departamenti i turizmit në mbështetje të këtij programi studimi;</li> <li>6. Nuk ka tregues që referojnë standardin më të lartë të cilësisë në veprimtarinë mësimore-kërkimore shkencore në departament në përputhje me kodin e cilësisë të parashikuar në Ligjin e arsimit të lartë;</li> <li>7. Mungesa e studimeve të tregut, e identifikuar qoftë nga dokumentacioni apo edhe nga vizita në institucion, ka çënuar dhe penguar procesin e realizueshmërisë, aq më tepër kur ai konsiderohet objektiv strategjik për programin;</li> <li>8. Nuk ka një analizë konkrete apo raportim se në cilat projekte konkretisht të jenë përfshirë studentët e këtij programi;</li> <li>9. Departamenti nuk ka as marrëveshje me Bashkinë e Durrësit apo njësi të tjera publike të përfshira direkt apo indirekt në zinxhirin e vlerës që prodhon turizmi në rajonin e Durrësit. Diskutimi në institucion rezulton me një qasje pak a shumë të justifikimit se marrëveshjet bëhen në nivele institucionale, ndërkohë që po gjykojmë programin e studimit të departamentit të turizmit.</li> </ol> <p>Institucioni në mbështetje të mirëfunksionimit të programit të</p>
--	--

studimit ka hartuar edhe një plan marketingu për të mbështetur dhe fuqizuar konceptimin dhe rëndësinë e këtij programi.

Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit Master Profesional në "Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike" bën lidhjen mes nevojave të ekonomisë së vendit dhe tregut të punës. Në thelb ky Plan Strategjik identifikon nevojën imediate për ofrimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike" si dhe efektet pozitive që ky plan do të ketë si në kualifikimin e specialistëve, ashtu dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, dhe hedh dritë mbi kapacitetet njerëzore, infrastrukture dhe financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, për realizimin e tij.

Në të thuhet: *“Formimi i specialistëve drejtues të ndërmarrjeve turistike është relativisht i ri dhe nuk ofrohet gjerësisht nga Universitetet Shqiptare. Ndërsa diversiteti i formave të Turizmit që ofron Shqipëria, kërkon formimin sa më cilësor të drejtuesve të aftë e të suksesshëm, që do të ndikojnë në reduktimin e sezonalitetit dhe në shtrirjen e veprimtarive të Turizmit të Qëndrueshëm gjatë gjithë vitit. Ky objektivi shtron si nevojë imediate formimin e menaxherëve specialistë.”*

Nga ana tjetër, në strategjinë e programit të studimit theksohet se qëllimi është të mundësojë aplikimin e praktikës jashtë auditoreve. Por ndërkohë:

1. Nuk ka shpjegime se si është realizuar ky qëllim në vitin e parë të funksionimit të tij, nuk ka shembuj konkretë se si është zhvilluar ajo, si janë aftësuar me njohuri praktike studentët në lëndë specifike, si psh. në lëndën industria turistike dhe organizimi i saj, analizë kostoje, etj.
2. Nuk ka analiza apo thjesht raportime brenda departamentit se si është arritur të mundësohet punësimi i ndonjërit prej studentëve në bizneset me të cilat departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi, si Hotel Premium apo Harmonia Group.

Ndërhyrja në këtë seksion me këtë argument, thekson edhe njëherë rëndësinë e marrëveshjeve dhe realizimit të tyre, 700 ndërmarrje turistike në rajonin e Durrësit, pak km larg nga UAMD kanë nevoja galopante, të paeksploruara dhe nevojë për dije, me nevojë për aftësi e aftësi dhe studentë të këtij profili.

	<p>Por në fakt rezultojnë disa marrëveshje që nuk evidentohen si efëçente sepse nuk kanë prodhuar praktika dhe studentë që të kenë kryer praktikën në këto ndërmarrje. Që do të thotë se studentët e këtij programi i përkasin një programi që përpos se është pa studim tregu, por edhe pa qasje ndaj biznesit në kohën që është zhvilluar dhe kryer si program studimi.</p> <p><i>Evidenca 4, Plani strategjik i Master profesional Drejtimi i Ndërmarrjeve Turistike.</i>  <i>Evidenca 34, Marrëveshje bashkpunimi të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 34.1, Tabelë përmbledhëse me institucione bashkëpunuese UAMD.</i>  <i>Evidenca 34.2, MoU UAMD.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e departamentit, takimi me pedagogët e programit, takimi me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Aktualisht nuk ofrohen trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, paraqet problem lidhur me përmbajtjen pasi përfshin marrëveshje të përcaktuara ende, pra në proces dhe si të tilla nuk mund të kenë arritur përfitime. Gjithashtu për marrëveshjet që janë realizuar, si përfitime sillen vetëm shembuj të aktiviteteve të realizuara dhe jo tregues se si është përfituar në terma të punësimit apo përfshirjes së studentëve në tregun e punës. Këto evidenca janë minimaliste.</p> <p>Në plotësimin e dokumentacionit për vërejtjet apo sugjerimet e bëra nga ekspertë të ministrisë, rreth plotësimit të dosjes së paraqitur në ministri për hapjen e programit DNT, në përgjigje angazhohen për mundësi të bashkëpunimit me institucione që menaxhojnë politika dhe strategji si: Bashkia Durrës, Autoriteti Portual, Agjencia Kombëtare e Turizmit, CHËB - Cultural Heritage Without Border, Instituti i Statistikave, INSTAT, ALB Tours, Dea Travel, Hotel Adriatik, Harmonia Group, Premium Beach, FAFA, për realizimin e praktikave mësimore, por dhe orëve të mësimin të booking dhe overbooking. Lektorja që mundëson realizimin e kursit “Mikpritje dhe menaxhim hotelier”, si lëndë e karakterit aplikativ, zotëron kompetenca të nevojshme që në bashkëpunim dhe me stafin e trajnuar të strukturave akomoduese, të mundësojë trajtimin e këtij programi. Përpos këtij fakti, vihet re se:</p>

	<p>1. Për vitin 2018-2019 nuk është mundësuar realizimi i marrëveshjeve me Bashkinë Durrës, Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Institutin e Statistikave, ALB Tours, Dea Travel, ndërkohë që në media sociale evidentohet realizim praktikash në DRRKK e Durrës-it, institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, i cili në fakt nuk përbën ndërmarrje turistike;</p> <p>2. Njësia bazë nuk ka të argumentuar se sa ka kanë ndikuar negativisht mos nënshkrimi i tyre në realizimin e objektivave për lëndë të caktuara si, Mikpritje dhe Drejtim Hoteli.</p> <p>Në vijim të reflektimit që departamenti ka bërë ndaj sugjerimeve të Ministrisë së Arsimit:</p> <p><i>“Për realizimin e orëve të veçanta mësimore do të mundësojmë praninë e ekspertëve të ftuar vendas e të huaj në formën e “guest speaker” me ekspertizë të shquar në fushën e turizmit, kundrejt akteve ligjore përkatëse: Pier Paolo Ambrosdio - VIS dhe eksperiencia në Shqipëri - Eva Kushova - Visit Albania dhe DMO Albania si një mjet për marketimin e vendit - Giancarlo Dall’Ara - Albergo diffuso, Piccoli Musei, Turismo Chinese - Leonard Naci - Agjencia Kombetare e Turizmit - Lejla Hadzic- CHËB Cultural Heritage Without Borders - Ilda Kasa - Happy Tours - Muhamet Germen - Harmonia Group - Luljeta Mehmeti - ALB Tours D - etj”.</i></p> <p>Ndërkohë që nuk ka raporte apo informacione se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cili prej tyre ka referuar për studentët e këtij masteri gjatë vitit akademik 2018-2019;</li> <li>2. Çfarë është përfituar nga leksionet e të ftuarve që janë mbajtur gjatë këtij cikli studimi për studentët.</li> </ol> <p><i>Evidenca 18, Plotësimi i rekomandimeve të ekspertit MASR për programin MP DNT.</i></p> <p><i>Evidenca 35, Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit DT.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit Master Profesional DNT organizohet sipas ligjit, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS.</p> <p>Bazuar mbi dokumentacionin për hapjen e programit të studimit, dokumentat e programit mësimor dhe planit mësimor, dhe rregullore e programit të studimit, ka një shpërndarje sipas ligjit e moduleve dhe e krediteve, gjithashtu duke parashikuar sipas standardeve orët fizike, orët në auditor (leksione, seminare, praktika mësimore) dhe ato të studimit individual, orë për praktikat në terren apo përgatitjen e temës së diplomës ka një ndarje sipas ligjit e moduleve konkretisht:</p> <p>Lëndë bazë (A) <b>6 kredite - 10%</b>;</p> <p>Lëndë karakterizuese (B) <b>21 kredite - 35%</b>;</p> <p>Lëndë ndërdisiplinore dhe integruese (C) <b>17 kredite - 28%</b>;</p> <p>Lëndë plotësuese (D) <b>6 kredite - 10%</b>;</p> <p>Detyrime përmbyllëse, tema e diplomës (E) <b>10 kredite - 17%</b>.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit paraqitet shpërndarja e lëndëve sipas legjislacionit në fuqi në pikën 3.1, struktura e programit mësimor.</p> <p>Programi është në përputhje me legjislacionin në fuqi sa i përket ofrimit të lëndëve bazuar mbi sistemin e krediteve dhe lëndëve bazë e të detyrueshme, praktikën mësimore, dhe punimin/provimin e diplomës, me një total prej 60 kreditesh por nuk ka parashikuar lëndë me zgjedhje brenda programit.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>  <i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Duke iu referuar programit të studimit, përshkrimit të detajuar të lëndëve, mund të thuhet se ka një përpjekje për shpërndarje të dhënies së njohurive për të krijuar specialistët e kërkuar në fushën e drejtimit të ndërmarrjeve turistike, por nuk shihet një llojshmëri e gjerë profesionesh e specialitetesh. Brenda listës së lëndëve ka</p>



	<p>disa fusha që lidhen kryesisht me aspektet e marketingut dhe menaxhimit, por nuk ka qartësi lidhur me profesione apo specialitete brenda fushës së menaxhimit të ndërmarrjeve turistike. Kjo sigurisht kufizohet më tepër edhe nga mungesa e lëndëve me zgjedhje. Në reflektim të kësaj mungese dhe organizimit aktual të lëndëve, për të orientuar në formimin e shprehive në një llojshmëri të gjerë profesione, mund të ndërmerret orientimi në profesione në dy aspekte brenda menaxhimit të ndërmarrjeve turistike, ose në ndërmarrje të ndryshme brenda zinxhirit të vlerës në turizëm, ose në profesione që lidhen me funksionet më të kërkuara në të gjithë tregun turistik, ku mund të përmendim marketingun, teknologjinë dixhitale, etj.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Cënohet kjo kërkesë për shkak të përputhjes së termave dhe koncepteve kyçe nga një modul në tjetrin. Njohuritë nuk janë homogjene brenda një syllabusi, ka përplasje të koncepteve, vështirësi për të përshtatur brendësinë e moduleve dhe syllabuseve përkatëse me titullin e modulit apo kualifikimin e pedagogut. Vështirësohet profilizimi brenda modulit dhe thellësia e nevojshme e njohurive që studenti duhet të përftojë. Kjo përcillet edhe përmes vështirësisë së përputhjes së kualifikimit të pedagogut me lëndën që jep, vë në dilemë njohurinë finale që transmetohen, sa kritike është kuptimi i terminologjisë, parimeve dhe teorive kryesore të fushës, sa të përparuara janë vërtet njohuritë e transmetuara, sa kompetente janë aftësitë e transmetuara, apo sa profesional do të mund të jenë mbi këto njohuri studentët për të ofruar zgjidhje praktike të problemeve.</p> <p>Kështu, për t'u thelluar më tej në këtë argument: syllabuset dhe përputhshmëria e kualifikimit bazë të lektorit (titullarit) me subjektin dhe përplasje me lëndë të tjera apo çështje të brendësisë. Vihet re psh. lënda: <b>industria turistike dhe organizimi i saj</b>, së pari me lektorë primar formimi i përgjithshëm gjeografi, dhe asistent me doktoratura në gjeografi mjekësore, me një kualifikim 2 mujor në Kanada për turizëm të qëndrueshëm. Asistenti përkatës që jep lëndën në master është aktualisht pa master dhe doktoraturë, është me një diplomë 4 vjeçare.</p> <p>Së dyti: çështjet që trajtohen në këtë syllabus: rëndësia e industrisë së turizmit në shkallë globale dhe për Shqipërinë, faktorët influencues në zhvillimin e industrisë turistike, koncepti i</p>

	<p>kohës së lirë dhe pushimit, impaktet e turizmit në dimensionet sociale, ekonomike dhe kulturore, apo edhe koncepti i udhëtimeve. Tek ky syllabus trajtohet koncepti i kohës së lirë dhe pushimit, koncepti i udhëtimeve, i mikpritjes, i kreativitetit dhe qytetit kreativ.</p> <p>Ka dy probleme me këtë syllabus:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ka përplasje me lëndën (mikpritje dhe drejtim hoteli), sepse trajton të njëjtën gjë, mikpritjen;</li> <li>2. Ka një përmbajtje që nuk përputhet me titullin e lëndës.</li> </ol> <p>Nga ana tjetër, lënda <b>mikpritja</b> zhvillohet në semestrin e parë si lëndë më vete dhe vjen në semestrin e dytë dhe trajton përsëri konceptin e mikpritjes në lëndën industri turistike. Industria turistike ka përfunduar në konceptin e kohës së lirë. Pra, çështje të trajtimit të brendësisë së temave ndikojnë konkretisht në formimin e njohurive që i përcillen studentit.</p> <p>Lënda <b>Mikpritje dhe menaxhim hotelier</b>, analizon koston e hotelit, kostot fikse dhe variable, ndërkohë që ka lëndë enkas për këtë. Studentët bëjnë një lëndë analizë kostosh. Tek po ky syllabus trajtohen tipet e eventeve që ndërkohë që po këtë temë e trajton edhe syllabusi “Industria turistike” dhe që e trajton këtë çështje (eventet) në 4 orë.</p> <p>Përplasje të tilla, mospërputhje të brendësisë së syllabuseve me titullin e lëndës dhe moskompetenca e lektorëve, mundëson krijimin e paqartësisë së koncepteve tek studentët, ul mundësinë për marrjen e njohurive të reja dhe krijon konfuzioni përmes përsëritjes apo trajtimit nga aspekte të ndryshme të së njëjtit koncept.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 20, CV e stafit.</i></p> <p><i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas VKM 41, dt 24.01.2018, elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në: a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë</p>

	<p>formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; ë) programin lëndor (<i>syllabus-et</i>); f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin.</p> <p>Programi i studimit MP DNT ka probleme me elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuar të ciklit të dytë sipas VKM më sipër, për shkak se janë përcaktuar gjithë kategoritë, por në brendësi të elementëve sipas kategorive nuk ka një lidhje logjike me kërkesat për secilin element.</p> <p>Kështu psh:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Nuk ofrohen lëndë me zgjedhje. Kryerja e një studimi tregu do të identifikonte paraprakisht nevojën për kompetenca, aftësi dhe dije, gjë e cila do të prodhonte një shumëllojshmëri mundësish zgjedhjeje për studentët;</li> <li>Lënda bazë e detyrueshme është lëndë që lidhet me metodologjinë, por pa lidhje me programin e studimit si dhe zhvillohet në semestrin e dytë;</li> <li>Brenda lëndëve bazë dhe të rëndësishme në formim ka një përmbajtje jo të bazuar në titullin e lëndës.</li> </ol> <p>Ky program studimi ka nevojë për përmirësime cilësore të strukturës së programit, të përmbajtjes së çdo syllabusi, të sigurimit të mos përplasjes së koncepteve, të konsultimit me ekspertë të fushës, akademikë, drejtues të ndërmarrjeve turistike të zonës, pra me të gjithë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në zinxhirin e vlerës. Ka nevojë për të tërhequr dhe reflektuar feedback të studentëve dhe stafit mësimdhënës, të përballjes dhe diskutimeve përfutuese që rezultojnë dhe të një përqaasjeje sa më optimale të çdo rezultati në programin e ardhshëm të këtij masteri.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas</p>	<p>Grupimi i të gjitha veprimtarive formuese, në lëndë/module është bërë sipas kategorive të përcaktuara dhe ka ngarkesën përkatëse në kredite, sikurse u ilustrua dhe në pikën II.1, kriteri 1. Mungojnë</p>

<p>kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>tek grupimi i veprimtarive formuese të kategorisë së lëndëve ndërdisiplinore, lëndët me zgjedhje të cilat janë të kërkuara në këtë kategori. Në këtë aspekt ka problem me përcaktimin e veprimtarive formuese sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e studimeve të UAMD.</i> <i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Praktika dhe Zhvillim karriere në programin e Masterit Profesional DNT është vendosur në grupin e lëndëve plotësuese me 5% të krediteve, konkretisht me 3 kredite dhe është organizuar në Institucion/Kompaninë ku studentët kanë zgjedhur të ndjekin praktikën. Evidenca për rregulloren e praktikës jep qëllimet e zhvillimit të praktikës në nenin 2 dhe procesin në nenet 3, 4, 5, të cilat tregojnë për ndjekjen dhe mënyrën e përmbushjes së detyrimeve të studentit lidhur me praktikën dhe rolin institucional. Por gjithashtu nga vizita në institucion, në pyetje specifike për praktikën mësimore, u vu re se nuk janë bërë marrëveshje me hotelet dhe operatorët turistikë për praktikën mësimore të studentëve që do të jenë specifikisht profesionistë për menaxhimin e ndërmarrjeve. Ndërkohë që pretendohet një numër prej 700 hotelesh në zonën e Durrësit dhe numri i studentëve të këtij masteri është shumë i vogël, momentalisht, duhet të hidhen bazat për lidhjen me tregun, pikërisht përmes praktikave dhe marrëveshjeve me hotelet dhe ndërmarrjet turistike dhe jo me institucione të tjera në nivele drejtimi, pushtet lokal apo qëndror, të cilat janë me vlerë, por jo konkretisht për këtë master profesional.</p> <p>Kështu, përmenden Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike të Shqipërisë (NATGA), Guida profesionale pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), por asnjë marrëveshje me agjenci konkrete apo hotele dhe njësi akomoduese për praktikën mësimore. Fokusi i praktikave duhet të jenë ndërmarrjet turistike në krye të listës dhe më tej angazhime të tjera, si bashkitë apo muzetë, të cilat janë më tepër burim praktike për studentë të dëgëve të tjera.</p> <p><i>Evidenca 10.3, Rregullore Praktike në Fakultetin e Biznesit.</i> <i>Evidenca 35, Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit DT.</i> <i>Evidenca 64, Shembull i kryerjes së praktikave profesionale DT.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UAMD është akredituar në nivel institucional në vitin 2016. Fakulteti i Biznesit pranë UAMD është njësi kryesore, e strukturuar për të ofruar programe studimi në ciklet e studimit në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë dhe bazuar mbi Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Departamenti është njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimit, duke realizuar të gjitha detyrat dhe mbajtur përgjegjësitë bazuar mbi Ligjin e Arsimit të Lartë. Bazuar në evidencën e Statutit dhe rregullores së UAMD, si edhe bazuar mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësi kryesore – fakulteti përmbush detyrimet ligjore përkatëse. Departamenti i Turizmit, brenda Fakultetit të Biznesit, lëshon diplomën e ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve Turistike” (MNT).</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i> <i>Evidenca 5, Rregullore e UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në evidencat 2 dhe 5, Statuti dhe Rregullorja e UAMD, paraqiten të gjitha kushtet e organizimit dhe strukturës që lidh departamentin dhe fakultetin, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe organeve të tyre drejtuese, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore. Departamenti i Turizmit është pjesë e Fakultetit të Biznesit dhe organizohet si pjesë e tij, por nuk organizohet brenda tij në grupe mësimore. Funkcionet e departamentit përcaktohen në tri sfera, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe veprimtaritë administrative.</p> <p>Fakulteti i Biznesit është i përbërë nga 5 departamente, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Ekonomike, i cili ka në përbërje të tij 13 PAE, nga ku 11 janë me grada/tituj;</li> <li>2. Departamenti i Turizmit, i cili ka në përbërje të tij 8 PAE, nga ku 7 janë me grada/tituj;</li> </ol>

	<p>3. Departamenti i Menaxhimit, i cili ka në përbërje të tij 13 PAE, nga ku 7 janë me grada/tituj;</p> <p>4. Departamenti i Marketingut, i cili ka në përbërje të tij 13 PAE, nga ku 10 janë me grada/tituj;</p> <p>5. Departamenti Financë-Kontabilitet, i cili ka në përbërje të tij 17 PAE, nga ku 11 janë me grada/tituj.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i>  <i>Evidenca 5, Rregullore e UAMD.</i>  <i>Evidenca 23, Të dhëna tabelare për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i>  <i>Evidenca 75, Struktura UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Departamenti i Turizmit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në DNT përmbush kushtet ligjore lidhur me stafin akademik.</p> <p>Për vitin akademik 18-19, Departamenti ka në përbërje të tij 8 personel akademik efektiv (PAE), ndër të cilët 1 me titullin Prof. Dr, 6 me gradën shkencore Doktor dhe 1 me Msc., si dhe 11 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku 8 me gradën shkencore Doktor dhe 3 Msc.</p> <p>Për vitin akademik 19-20 (<i>duke përfshirë planifikimin e bërë për semestrin e dytë</i>), Departamenti ka në përbërje të tij 8 personel akademik efektiv (PAE), ndër të cilët 1 me titullin Prof. Dr, 6 me gradën shkencore Doktor dhe 1 me Msc., si dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku 10 me gradën shkencore Doktor dhe 2 Msc.</p> <p>Raporti PAE/PAK është afërsisht 0.73 (18-19) dhe 0.67 (19-20) në favor të PAK. Lidhur me departamentin ky është një raport jo shumë i favorshëm, pasi supozohet që nevojat për staf të mbulohen më tepër nga departamenti sesa nga jashtë. Lidhur me programin e studimit raporti ndryshon në të kundërt, pasi ka 8 PAE dhe 1 PAK, për 2 vitet e fundit akademike, pra raporti 8 në favor të PAE.</p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit dhe stafin e programit të studimit 2018-2019.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën</p>	<p>Sikurse argumentuar edhe më sipër, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, pra FB dhe Departamenti i Turizmit, përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>

akademike.	
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Evidencat paraqesin se ka një personel ndihmës akademik për programin e studimit. Ai mbështet lidhur me praktikat mësimore, dokumentacionin, etj. Programi në rregulloren e tij parashikon se personeli ndihmës, sekretar i departamentit ka si detyrë mbështetjen edhe të komunikimit për praktikat mësimore si edhe punën me dokumentat e marra nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullore e programit të studimit, neni 14 mbi sekretarinë e departamentit.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit dhe stafin e programit të studimit 2018-2019.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nuk ka ne rregullore një person të caktuar si Koordinator të programit të studimit. Në rregullore përcaktohet se përgjegjësi i departamentit është koordinatori i programit (neni 11) që dmth se përgjegjësitë për ecurinë e programit të studimit i ka përgjegjësi i departamentit. Por duke qenë se departamenti ka aktualisht 3 programe bachelor dhe këtë program në nivelin master, evidenca 36 tregon se vetëm në këtë rast koordinatori është përgjegjësi i departamentit. Nga vizita në institucion dhe pyetjet specifike për koordinatorin u gjet se gjithë dokumentacioni i programit që mendohet të mbahet nga koordinatori, mbahet në mënyrë të publikuar nga përgjegjësi i departamentit dhe GVJ gjykon se kjo është një zgjidhje jo e duhur, sidomos kur ky rol është i kërkuar nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mirëorganizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit. Mjafton që këtë detyrë ta marrë një person brenda departamentit, pasi përgjegjësi ka ngarkesë për menaxhimin e departamentit.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 36, Vendimi-Memo per caktimin e koordinatorit te programit te studimit.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e departamentit, takimi me stafin e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Vizita në institucion vuri në dukje se gjatë diskutimeve nuk ishte kuptuar mirë roli i koordinatorit për programin e studimit dhe ky është menduar si një aspekt që mund të përmirësohet me kohën, duke qenë se në rregulloren e programit është lënë hapësirë për këtë. Dokumentacioni publikohet dhe mbahet nga përgjegjësi i departamentit. Kjo nuk garanton mbarëvajtje pasi roli i</p>

	koordinatorit është të vërë në dukje problematika apo mbarëvajtje në relacion me programin. Nuk ka kuptim zbatimi i kësaj procedure nga departamenti.			
	<i>Vizita në IAL, takimi me stafin e programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Informacioni është bazë për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ligje, vendime, udhëzime, rregullore, statuti, vijnë nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, miraton rregulloret përkatëse dhe përcjell informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet. Gjithashtu, Departamenti disponon informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit, lidhur me marrëdhëniet me studentët, të shprehura në statut, rregullore si dhe bazuar mbi rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i Ri UAMD.</i>  <i>Evidenca 5, Rregullore e Re UAMD.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 54, Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit organizohet në kategoritë si më poshtë:  Lëndë bazë të detyrueshme (A) - 1 lëndë, 6 kredite - 150 orë total;  Lëndë karakterizuese (B) - 3 lëndë, secila nga 7 kredite - 525 orë;  Lëndë ndërdisiplinore (C) - 3 lëndë, nga 5 dhe 7 kredite - 425 orë;  Lëndë plotësuese (D) - 2 lëndë, 3 kredite - 150 orë, nga të cilat njëra është praktikë profesionale - 75 orë.  Lëndë e detyrime përmblylëse (E) - mikroteza, 10 kredite - 250 orë.</p> <p>Shihet se raporti midis kategorive të lëndëve formuese është sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Problem është mungesa e lëndëve me zgjedhje në kategorinë e lëndëve plotësuese ku sipas VKM 41, duhet të ketë lëndë me zgjedhje.</p>



	<p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL)</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, evidenca 112, kurrikula Master Profesional DNT.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit DNT organizohet në lëndë sipas sistemit të krediteve, ku 1 kredit është 25 orë mësimore, është ndarë sipas ngarkesës në auditor dhe jashtë auditorit dhe gjithashtu ka një ndarje të lëndëve në semestra, me një ngarkesë prej 5 lëndë në semestrin e parë, me 27 kredite, gjithsej 675 orë të punës së studentit dhe semestrin e dytë 3 lëndë, praktika profesionale dhe mikroteza, një ngarkesë prej 33 kreditesh ose 825 orë pune të studentit. Shihet se nuk është bërë një ndarje e barabartë midis semestrave, por është lënë pak më tepër ngarkesë semestrit të dytë.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL)</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, evidenca 112, kurrikula Master Profesional DNT.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, gjenden në dosjen e programit të studimit si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe kurrikulën e programit. Vendimi i miratimit të rregullores së programit është i qershorit 2019.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullore e programit të studimit;</i></p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL)</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, evidenca 112, kurrikula Master Profesional DNT.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacioni për studentët, që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit gjendet i pasqyruar në disa prej dokumentave të IAL.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit, seksioni 7 (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p>

	<i>Evidenca 101, Memo kriteret për aplikim në MP DNT. Evidenca 103, Vendim departamenti i dt 5.10.2018.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e detajuara për secilën lëndë janë pjesë e programit të studimit. Por nuk ka një program për praktikën dhe një plan për orët jashtë auditorit është thuajse në mungesë, pasi nuk përshkruhen në syllabus detyra apo punë të studentit, projekte, etj, përveç orëve të seminareve.  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve. Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL). Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ky kriter nuk mund të vlerësohet efektivisht në këtë program studimi pasi ka vetëm një vit që është hapur dhe pas vitit të parë po bëhet vlerësimi i programit të studimit. Megjithatë, në disa raste vihen re ndryshime në syllabuse nga syllabuset e propozuara në dosjen e programit të studimit, pra në fillim të aplikimit (ndryshime në lëndën “ICT në turizëm”, “Menaxhim i burimeve njerëzore në turizëm”).  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve. Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL). Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit, në total është një ngarkesë prej 1500 orë pune në total të studentit, të cilat përfaqësohen nga 60 kredite, shpërndarë sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.  <i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT. Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL). Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, evidenca 112, kurrikula Master</i>

	<p><i>Profesional DNT.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitë në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i veprimtarive dhe përmbajtja kanë në disa raste problematika me thellimin e njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. P.sh., “ICT në turizëm” është lëndë shumë e rëndësishme sot për veprimtarinë e ndërmarrjeve turistike, por përmbajtja e lëndës ka një disproporcion lidhur me njohuritë e këtyre teknologjive lidhur me turizmin, 3 tema në 16 të tilla, krahasuar me njohuritë e përgjithshme, që studentët sot në përgjithësi i marrin në bazat e informatikës në nivelet më të ulëta të studimeve. Gjithashtu koncepte të detajuara lidhur me sigurinë e informacionit, teknikat inteligjente, sistemet e menaxhimit të njohurive, nuk u shërbejnë konkretisht studentëve të masterit profesional në turizëm, për profilin që ata duhet të kenë në treg. Programi i lëndës “Mikpritje dhe menaxhim hotelier” është një miks i koncepteve dhe temave që përmbahen në lëndë të tjera, si “Analiza e kostove” dhe “Marketingu i turizmit”, dhe nga ana tjetër nuk paraqet një fill logjik lidhur me renditjen apo kombinimin e temave, duke krijuar nga një anë konceptin e menaxhimit në tipe të ndryshme të ndërmarrjes dhe nga ana tjetër trajtimin e fushave të ndryshme funksionale brenda ndërmarrjes. Siç u përmend edhe më lart (standardi II.1, kriteri 3) lënda Industria turistike dhe organizimi i saj gjithashtu paraqet disa probleme lidhur me përmbajtjen, pasi ajo nuk përputhet me emërtimin e lëndës dhe trajton koncepte të lëndës së Mikpritjes në semestrin e parë.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Objektivat formuese të programit të studimit paraqiten në evidencën 7, rregullore e programit dhe në evidencën 14, dosja e programit. Sipas vlerësimit gjithashtu të syllabuseve të lëndëve dhe kombinimit të lëndëve sipas kategorizimit të disiplinave, por edhe nga vizita në institucion arrijmë në përfundimin se ka përpjekje për të thelluar njohuritë, por gjithashtu ka përplasje të koncepteve në lëndë të ndryshme dhe kjo nuk ndihmon në arritjen e objektivave të thellimit të njohurive dhe zhvillimit të dijeve. Gjithashtu konceptet për tipe të ndryshme të ndërmarrjeve turistike janë të shpërndara në disa lëndë, bëhen përsëritëse dhe</p>

	<p>nuk krijojnë mundësinë që studenti të kuptojë tipet e ndërmarrjeve dhe operacionet brenda tyre. Gjithashtu mungon koncepti i zinxhirit të vlerës që është shumë i rëndësishëm kur flitet për ndërmarrjet turistike.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>  <i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë ka disa mospërputhje me profilin e programit master. Sidoqoftë, përafërsia me programe të ngjashme ndërkombëtare është e vështirë për tu gjykuar pasi kryesisht titujt e programeve master janë Menaxhim në mikpritje ose menaxhim në turizëm, ose menaxhim në turizëm dhe mikpritje, por jo menaxhim në sipërmarrjet turistike. Pra prirja e diplomave ndërkombëtare është ndarja e sektorëve brenda industrisë turistike, pasi secili ka karakteristikat e veta.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, evidenca 112, kurrikula Master Profesional DNT.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raporteve teori/praktikë, mundësojnë arritjen e disa objektivave, por jo plotësisht arritjen e objektivave formuese. Sa i përket transferimit të studimeve, nuk mund të thuhet se është zbatuar një masë 70% e lëndëve të ngjashme me programe të tjera, gjë që garanton transferimin e studimeve. Sa i përket mobiliteteve ato janë aplikuar nga departamenti, por jo për këtë program studimi. Problematikat me punësimin u diskutuan dhe në kriterin 2 të këtij seksioni.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, evidenca 112, kurrikula Master Profesional DNT.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në disa raste literatura është më e vjetër se 5 vitet e fundit, psh, ka literaturë të vitit 2010 ose edhe më të vjetër. Vihen re disa ndryshime, përditësime të programit në disa lëndë, por literatura e kohëve të fundit mbetet problem për disa lëndë, ndërsa në disa të tjera si psh. tek analiza e kostove nuk jepet fare viti i botimit të literaturës në gjuhë të huaj dhe nuk thuhet të kujt periudhe janë materialet e leksioneve.</p> <p>Gjithashtu, ka disa tekste në gjuhën shqipe në bibliotekë, ku ndodhen gjithashtu edhe ciklet e leksioneve, për tu aksesuar nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>  <i>Vizita në IAL, vizita në bibliotekën e Institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi kostot, burimet njerëzore, industrinë e turizmit, konceptet e mikpritjes dhe menaxhimit të ndërmarrjeve, Komunikimit dhe marketingut. Megjithatë, GVJ i qendron linjës së diskutimit të përmirësimit të përmbajtjes së lëndëve duke u përshtatur me emërtimet ose duke u përmirësuar, bazuar me kompetencat të cilat synohen të formësohen tek studentët e programit. Për shembull, lënda “Industria turistike dhe organizimi”, kompetencat që do të duhet të ndërtojë: aftësitë për të kuptuar funksionimin e industrisë, kuptimi i zinxhirit të vlerës/ofertës, si ndërlidhen nënsektorët e industrisë dhe si ndikon kjo në menaxhimin e aktiviteteve turistike, etj.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Organizimi i programit siguron formimin profesional duke u zgjeruar në shumë fusha brenda drejtimit (menaxhimit) dhe duke u munduar të kapë sa më shumë aspekte të këtyre fushave, të lidhura me turizmin. Jo gjithnjë kjo është e mundur, sidomos në lëndë si Menaxhimi i burimeve njerëzore apo ICT. Programet dhe syllabuset ofrojnë pak njohuri specifike dhe të thelluara për turizmin, ato qëndrojnë më shumë në aspektin menaxherial, apo</p>

	<p>teknik. Ndërkohë që ka lëndë të cilat janë brenda fushës së turizmit duke dhënë koncepte të lidhura me njëra tjetrën si Sistemet kulturore territoriale apo Komunikimi dhe marketing i turizmit.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit (risjellë edhe në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Duke qenë një program i ciklit të dytë Master Profesional, studenti nuk synon vazhdimin e mëtejshëm të studimeve, por punësimin. Nga evidenca e punësimit të studentëve duket se pjesa dërrmuese e tyre janë punësuar, disa kanë qenë të punësuar më parë dhe kjo është një prirje e vazhimit të studimeve për të mbështetur pozicionin në tregun e punës (intervista me studentët). Disa të tjerë janë punësuar gjatë vitit 2019.</p> <p>Gjithsesi nga diskutimi doli ideja se lëndët japin pak a shumë të njëjtat njohuri si në Bsc., dhe kjo nuk shërben shumë në treg. Më shumë njohuri do të duheshin nga ana e studentëve, nga burime të tregut aktual, se sa domosdoshmërisht nga pedagogë me grada e tituj, por që janë larg tregut. Këtu problem themelor, siç e sheh GVJ nuk janë mungesa e gradave, por duke qenë kualifikimet e një pjese të stafit, jo të lidhura me turizmin, kjo bën që ata të mos njohin tregun e turizmit, pasi studimet e tyre nuk janë të lidhura me fushën, ose janë të lidhura shumë pak, vetëm tangjent.</p> <p><i>Evidenca 29, Të dhëna tabelare për punësimin real të studentëve.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me studentët e programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>		

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin</p>	<p>Për vitin akademik 18-19 personeli akademik përbëhet nga: <b>8</b> PAE, me kualifikimin: 1 Prof. As, 5 Dr. dhe 2 Msc., dhe <b>1</b> PAK me kualifikim Prof. Dr.</p>

<p>kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Për vitin akademik 19-20 (<i>duke përfshirë planifikimin për semestrin e dytë</i>) personeli akademik përbëhet nga: <b>8 PAE</b>, me kualifikimin: 1 Prof. As, 6 Dr. dhe 1 Msc., dhe <b>1 PAK</b> me kualifikim Dr.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka staf akademik me Msc. të angazhuar në këtë program studimi dhe jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve janë të kategorise “Profesor”, sikurse kërkohet nga parashikimet ligjore në fuqi.</p> <p>Raporti PAE/PAK lidhur me ngarkesën mësimore, për vitin akademik <b>18-19 është 90 % PAE / 10 % PAK</b>, ndërsa për vitin akademik <b>19-20 (duke përfshirë planifikimin për semestrin e dytë)</b>, raporti është <b>88.3 % PAE / 11.4 % PAK</b>. Sa më lart, në të dy vitet akademike, stafi akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore në masën të paktën 70 %.</p> <p>Në këtë program studimi, ngarkesa e stafit akademik efektiv në numër lëndësh/modulesh varion në 1-2 lëndë vjetore, ndërsa e stafit akademik me kontratë në 1 lëndë/modul. Ngarkesa në orë mësimore, në këtë program studimi, për stafin akademik efektiv varion nga 35 orë në 135 orë, ndërsa e stafit akademik me kontratë është 75 orë.</p> <p>Ngarkesa e përgjithshme në numër lëndësh e stafit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi, edhe në programe të tjera studimi, shkon deri në 5 lëndë vjetore, ndërsa ngarkesa në orë mësimore varion nga 250 deri në 465 orë mësimore.</p> <p>Ngarkesa e përgjithshme në numër lëndësh e stafit akademik me kontratë të angazhuar në këtë program studimi, edhe në programe të tjera studimi, shkon deri në 2 lëndë vjetore, ndërsa ngarkesa në orë mësimore shkon deri në 120 orë.</p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, kurikula Master Profesional DNT.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit dhe stafin e programit të studimit 18-19.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit, 19-20.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, ngarkesa totale e stafit akademik te angazhuar ne programin MP DND.</i></p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, ngarkesa PAE dhe PAK për sem. I-rë dhe parashikimi për sem. II-të, v.a 2019-2020.</i></p>
----------------------------------	---

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Ka probleme të përputhjes së formimit bazë të stafit me fushën e turizmit. Njohuritë dhe formimi bazë i disa prej stafit me modulet dhe lëndët që japin dhe ofrojnë përbëjnë një tjetër aspekt të mospërputhshmërisë brenda këtij programi studimi. Ka raste që pedagogë pa doktoraturë japin lëndë në master ose kur formimi i tyre po orientohet në drejtim tjetër. Gjithashtu pedagogë me formim të ndryshëm nga ai i lëndëve që japin e bazojnë këtë në faktin e kualifikimeve 2 mujore.</p> <p><i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit dhe stafin e programit të studimit 18-19.</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, të dhëna tabelare për stafin e Departamentit të Turizmit, 19-20.</i>  <i>Evidenca 20, CV stafi akademik i departamentit të turizmit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike ka papërputhshmëri në disa raste me fushën e turizmit. Mund të ketë fusha të lidhura, por jo në aspektin e menaxhimit të ndërmarrjeve. Kështu ka kualifikime në gjeografi, arkeologji, juridik dhe kërkime në fushën e shëndetit publik, ose siç ka edhe pedagogë me formim të mirë në aspektin praktik dhe profesional, por pa angazhim në punën kërkimore shkencore.</p> <p><i>Evidenca 20, CV stafi akademik i departamentit të turizmit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli i brendshëm i departamentit është në dispozicion të udhëzimit dhe udhëheqjes së studentëve në praktikën profesionale dhe punimin e diplomës, sipas rregulloreve të përcaktuara për praktikën dhe diplomat, duke u përcaktuar nga përgjegjësi i departamentit, i cili bën ndarjen e ngarkesës sipas numrit të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomës.</i>  <i>Evidenca 10.3, Rregullore e praktikës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në përgjegjësitë e sekretarit të departamentit është edhe mbështetja e duhur për realizimin e orëve dhe mirëmbajtjen. Por ky program studimi nuk ka të aplikueshme laboratorët specifike, ndaj stafi mbështetës i departamentit nuk e ka këtë detyrë.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



standardit			X	
------------	--	--	---	--

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Aktualisht përmes vizitës në institucion kuptuam se nuk ka marrëdhënie konkrete lidhur me programin e studimit, me operatorët në treg për të realizuar ndryshime apo përmirësime të nevojshme të kurrikulës, bazuar në nevojat e tregut të punës. Ka disa marrëveshje bashkëpunimi, por që nuk evidentohet se përdoren për këtë qëllim, por vetëm për qëllimet e praktikave. I vetmi studim i pretenduar pas diplomimit, në fakt merr vetëm disa të dhëna mbi operatorët, në nivel makro, për të treguar ofertën në tregun e punës, por nuk merr informacion të plotë mbi nevojat e tyre për aftësitë e njerëzve të kërkuar nga ndërmarrjet turistike aktualisht. Gjykojmë se nuk merret informacion i nevojshëm nga tregu i punës me synim përmirësimin e programit.</p> <p><i>Evidenca 17, Studimi i tregut pas përfundimit.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me studentët, takimi me stafin akademik, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion përfshirja e studentëve është vetëm në formën e realizimit të anketave të studentëve, ku ata vlerësojnë procesin e mësimdhënies dhe lektorët përkatës. Kështu, ka momente themelore tek pyetësorët që studentët plotësojnë, duke u bazuar tek shumë variabla, mënyra e komunikimit, spjegimit, sa infrastruktura është mbështetje në procesin e mësimdhënies, etj.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Sektorin e alumni dhe karrierës ka bërë përpjekje në këtë drejtim, duke strukturuar për të ardhmen disa të dhëna që mendohet të merren për programin e studimit. Nga vizita, takimi me zyrën e kurrikulës doli se për këtë i rëndësishëm është bashkëpunimi me pedagogët e programit.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private,</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe njësitë e</p>

<p>njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>pushtetit vendor, por bën përshtyje që nuk e ka filluar nga ato më të afërtat, por duke krijuar lidhje me bashkinë e Tiranës, apo ATA, ka dashur të komunikojë një mundësi punësimi në nivel kombëtar në Turizëm dhe jo lokal. Ky synim del edhe nga vizita në institucion.</p> <p><i>Evidenca 35, Raport Analitik mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit DT. Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, takimi me stafin akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b>  <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nuk ka udhëzues të veçantë në nivel institucional për metodat inovative në mësimdhënie. Neni 7 i rregullores për NJSBC udhëzon përdorimin e teknologjisë për vlerësimin e njohurive dhe dijeve, me synim eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit dhe rritjen e transparencës. Gjithashtu nga vizita në terren stafi përdor teknologjinë me videoprojektor, foto, pamje e video gjatë procesit të leksioneve. Nuk përmenden në mënyrë të shkruar format inovative të ndryshme në proces, si “të mësuarit përmes aktiviteteve (learning by doing)”, diskutimet dhe puna në grup e studentëve brenda orës së mësimit, etj.</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i>  <i>Vizita në IAL, vëzhgimi i ambjentëve të Institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të</p>	<p>Sipas Statutit dhe rregullores së UAMD si edhe në detaj sipas rregullores së NJSBC janë ngritur strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës. Këto</p>


personelit akademik dhe ndihmësakademik.	struktura janë listuar në detaj në nenin 2 të rregullores së NJSBC.  <i>Evidenca 2, Statuti i Ri UAMD.</i> <i>Evidenca 5, Rregullore e Re UAMD.</i> <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, garantohet përmes pyetësorit të studentëve, i cili realizohet në fund të çdo semestri, javën e 13, 14. Ai vlerëson karakteristika si aftësitë komunikuese, profesionale, etikën dhe metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimin e dijeve të studentit. Detajet e procesit dhe strukturat përgjegjëse jepen në nenin 6 të rregullores së NJSBC. Gjithashtu, IAL ka vënë në dispozicion edhe evidencë të vlerësimeve për stafin e programit.  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i> <i>Evidenca 44, Vlerësimi i lektorëve të brendshëm;</i> <i>Evidenca 66, Vlerësimi i performancës së stafit nga studentët.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë bërë transparente përmes raportit për monitorimin e cilësisë, raporteve të analizës vjetore të departamentit. Megjithatë, në këtë raport rezultatet konkrete të pyetësorit të studentëve nuk janë paraqitur. Mund të gjendet forma përmbledhëse e bërjes publike të rezultateve të vlerësimit, pa cënuar privatësinë dhe anonimatën e stafit akademik që është një shqetësim i përgjithshëm në institucione.  <i>Evidenca 37, Raport i monitorimit të cilësisë në FB.</i> <i>Evidenca 38, Analiza vjetore e departamentit.</i> <i>Evidenca 41, Analiza pyetësorëve.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Promovimi i shembujve dhe praktikave të mira është bërë kryesisht përmes promovimit të aktiviteteve dhe marrëveshjeve nëpërmjet publikimit në Web site dhe mediat sociale.  <i>Evidenca 77, Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, viti akademik 2017-2018.</i> <i>Evidenca 81, Aktivitetet e Departamentit të Turizmit 2018-19.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksione, seminare, projekte/detyra (pjesë e vlerësimit të lëndës), praktika profesionale. Në planet mësimore përcaktohen orët totale për çdo lëndë, por jo e ndarë sipas leksioneve dhe seminareve për çdo lëndë. Kjo krijon paqartësi në ndarjen dhe organizimin e mëtejshëm të programit të studimit. P.sh. në evidencën shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion (37) plani mësimor i programit të studimit, lënda e parë në tabelën e programit me përbërësit specifike është “Metodat e kërkimit shkencor” ku përcaktohen 40 orë për leksione në auditor dhe 20 orë për veprimtari të tjera në auditor, supozohet seminare/laboratore, në këtë rast seminare. Duke qenë se semestri është 15 javë, kjo ndarje nuk arrin të përkthehet në një numër leksionesh dhe seminaresh në javë. Në tabelën e mëtejshme lënda ka 4 orë në javë. Nuk specifikohet se sa janë leksione dhe sa janë seminare. Nëse do të jenë 2 me 2 atëherë nuk qëndron shpërndarja 40 me 20 në orë totale, por do duhet të ishte 30 me 30. Nëse raporti leksione/seminare është 3/1 atëherë raporti i orëve totale leksion seminar do ishte 45/15. Pra, nuk ka përputhje midis deklaramit të raportit në orë ngarkese totale leksione/seminare dhe rrjedhimit që kjo do të ketë për këtë raport në ngarkesën javore të lëndës. Mungojnë evidencat e detajuara për planin mësimor në orë në javë leksione/seminare.</p> <p><i>Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL, kurrikula Master Profesional DNT.</i></p> <p><i>Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL, plani mësimor i programit të studimit MP DNT, v.a 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Duke analizuar syllabuset e lëndëve, shihet përfshirja e aspekteve të rëndësishme bazë të një syllabusi, por përveç sqarimit të mënyrave apo rasteve të trajtimit të seminareve, nuk shihet nxitja e formave ndërvepruese me studentin apo informacion më i detajuar mbi detyrat e kursit, apo vlerësimin e seminareve, çfarë do të përfshijnë detyrat apo projektet, etj. Syllabuset krijojnë më tepër një standardizim në pasqyrimin e formave dhe mënyrave të mësimdhënies/nxënies dhe nuk paraqesin forma që t’i përgjigjen diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me pedagogët e programit ata janë të hapur për të përmirësuar mësimdhënien dhe format e</p>

	<p>ndryshme të saj.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni nuk ka ndonjë politikë për rritjen e kapaciteteve të stafit lidhur me kompetencat didaktike, bëhet fjalë si për trajnime apo guida për rritjen e njohurive mbi metodat e reja në mësimdhënie dhe edukim, në arsimin e lartë, apo forma të tjera diskutimesh dhe debatesh brenda departamentit, forma të komunikimit me aktorët jashtë departamentit, alumni, apo dhe studentët aktualë për të identifikuar metodat më të mira dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu nga vizita në institucion, takimi me stafin e departamentit, u pa se mbështetja e institucionit lidhur me literaturën që është bazë në procesin e mësimdhënies mund dhe duhet të jetë më e madhe, me gjithë përpjekjet për të mbështetur blerjet sipas listave të kërkuara nga pedagogët.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga anketa e studentëve dhe rezultateve sipas evidencës 66 duket se ka një nivel në përgjithësi relativisht të lartë të vlerësimit për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Por nuk ka detajim të daljes së këtij rezultati sipas fushave të përcaktuara të pyetësorit sipas evidencës 44 të formës së vlerësimit të pedagogut.</p> <p>Nga evidencat e CV të stafit akademik sidoqoftë vihen re mospërputhje të kompetencave të ndërtaura mbi bazën e kualifikimeve si dhe fushave të kërkimit shkencor, nga njëra anë, me lëndët të cilat japin nga ana tjetër.</p> <p><i>Evidenca 44, Vlerësimi i lektorëve të brendshëm.</i>  <i>Evidenca 66, Vlerësimi i performancës së stafit nga studentëve.</i>  <i>Evidenca 20, CV stafi akademik i departamentit të turizmit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen periodikisht dy herë në vit nga studentët, përpara sezonit të provimeve, por gjithashtu bëhen vlerësime të performancës nga departamenti përmes përgjegjësit të departamentit dhe në bashkëveprim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p>


	<i>Evidenca 44, Vlerësimi i lektorëve të brendshëm.</i> <i>Evidenca 66, Vlerësimi i performancës së stafit nga studentëve.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Personeli akademik përpigjet të përdorë metoda interaktive, duke përdorur videot si forma nxitëse të diskutimit në klasë, duke nxitur studentët të gjejnë dhe hulumtojnë përmes internetit në materiale ndërvepruese. Gjithashtu metodat interaktive nxiten nga përdorimi i video projektorit.  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nuk mund të flasim konkretisht për efektin e formave të mësimdhënies tek studentët, pasi nuk patëm një përfaqësim të kënaqshëm të studentëve të programit. Megjithatë, mësimdhënia vlerësohet si relativisht e mirë, duke ngritur vlerat e rasteve të pedagogëve me përvoja në tregun e punës si dhe të backgroundit akademik të provuar lidhur me turizmin. Njoftimet për internship, praktika, ka patur, por jo drejtpërdrejt të lidhura me interesat e studentëve të programit Master profesional DNT.  <i>Evidenca 38, Analiza vjetore dep. Turizmit 2018-2019.</i> <i>Evidenca 38.1, Analiza e Departamentit për programin e studimit MP DNT.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.3</b> <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Godina e ndërtuar rishtazi ka hapësira të mjaftueshme dhe të bollshme për të realizuar procesin mësimor e shkencor. Godina 2B përfshin ambjentet e FB, me mjedise të përshtatshme referuar numrit të studentëve dhe kriterëve sipas VKM 418, dt. 10.05.2017.  <i>Evidenca 42, Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i> <i>Evidenca 74, Foto të ambjenteve.</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i ambjenteve të Institucionit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me	Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>cilësi të procesit mësimor dhe praktikave, i cili përfshin sallat me videoprojektor për leksionet si edhe laborator të vendosur në dispozicion të atyre orëve për të cilat është e nevojshme kryesisht ICT në turizëm.</p> <p><i>Evidenca 42, Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 74, Foto të ambjenteve.</i>  <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i ambjenteve të Institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me NJSBC, pyetja mbi sistemin IT rezultoi në përgjigje mbi dy sisteme të informacionit, ku AULA është sistem i zbatuar më parë nga programi 2 vjeçar dhe i dyti, Pitagora, është në ndërtim e sipër. Programet Master nuk kanë përdorur dhe as nuk përdorin aktualisht sistem informacioni. Nga ana tjetër infrastruktura IT lidhet kryesisht me hardware, kompjutera printera, lidhje internet (jo WiFi), e cila është në nivele të mira. Vetëm kjo infrastrukturë nuk është e mjaftueshme për rolin e IT në një proces cilësor të mësimdhënies/mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca 46, Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë Manual_Aula.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit u evidentua se ka probleme me literaturën në përgjithësi, duke qenë se pedagogët kanë investuar vetë në gjetjen e literaturave më të reja, por nga ana tjetër ka përpjekje për listim të literaturave të përshtatshme dhe të nevojshme, për tu blerë më tej me fondet e bibliotekës. Pedagogët kanë ndërtuar ciklet e leksioneve, të cilat janë vënë në dispozicion në bibliotekë, ku gjenden edhe disa tekste në shqip, që mund të përdoren për programin e studimit. Gjithashtu ka akses në librarinë online të vendosur në dispozicion nga RASH, ku nga vizita në bibliotekë u evidentuan raste të përdorimit të sistemit nga studentët. Megjithatë, më shumë përpjekje duhet të bëhen për të patur literaturë në gjuhën e programit të studimit, sidomos literaturë të printuar dhe të vitve të fundit pasi aktualisht ajo është më e vjetër se e 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Evidenca 42.2, Të dhëna për infrastrukturën (Plani strategjik biblioteka-2015-2020).</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin e programit dhe vizita në bibliotekën e</i></p>

	<i>Institucionit.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<p>Biblioteka ofron mjedise komode studimi dhe përdorimi nga studentët gjatë programit mësimor. Vizita në bibliotekë evidentoi raste të studentëve që punonin dhe aksesonin kompjuterat dhe internetin. Numri i botimeve të viteve të fundit gjithsesi duhet të rritet, sidomos duhet të punohet për literaturën shqip, përmes programeve të përkthimit si ai i CleanScore, i cili nuk njihej nga stafi akademik i programit, në aspektin e shërbimit suportues për përkthimin e teksteve.</p> <p><i>Evidenca 42.2, Të dhëna për infrastrukturën (Plani strategjik biblioteka-2015-2020).</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin e programit dhe vizita në bibliotekën e Institucionit.</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<p>Akresi i personelit lidhur me librarinë on-line është i kufizuar, disa nuk e dinë ekzistencën e mundësisë për të aksesuar online, ose janë mosbesues. Institucioni nuk ka vetë akses në biblioteka on-line. Por nga ana e stafit të bibliotekës bëhen përpjekje për të ndihmuar dhe mbështetur si stafin, si studentët për të aksesuar në Urash.library (aksesin në EBSCO, të ofruar nga MASR).</p> <p><i>Vizita në IAL, vizita në bibliotekën e Institucionit.</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Infrastruktura laboratorike përdoret pak nga studentët e programit, pasi nuk ka lëndë të aplikueshme në laborator përveç ICT në turizëm (Vizita në Institucion, takimi me studentët), por nga ana e stafit akademik, ka plane për të përmirësuar në laboratorët ekzistues aksesin në programe që mund të jenë specifike për turizmin në aspektin e menaxhimit të teknologjisë.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me studentët.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>Nuk ka platformë on-line e-learning dhe nxitje të personelit për përdorim të tyre. Theksojmë se kjo mund të bëhet edhe individualisht, apo në nivel departamenti, pasi teknologjitë e sotme dhe interneti lejon sipërmarrjet individuale lidhur me informimin dhe shpërndarjen e materialeve, etj. Programi AULA jo i përdorur për këtë program studimi siç u tha edhe gjatë takimeve në IAL.</p> <p><i>Evidenca 46, Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë Manual_Aula.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alunit dhe</i></p>



	<i>Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	<p>Nuk ka sisteme të komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacion elektronik për studentët dhe personelin akademik. Komunikimet bëhen përmes adresave të e-mailit. Programi AULA jo i përdorur për këtë program studimi siç u tha edhe gjatë takimeve në IAL.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i> <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Ka një rregullore të tezës së diplomës për masterat e nivelit të dytë në UAMD duke përfshirë dhe MP DNT. Neni 3 jep përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor duke përbushur detyrimet për mbështetjen, orientimin dhe asistimin në procesin e diplomimit përmes temës së diplomës. Megjithatë nga vizita në institucion (<i>takimi me stafin akademik</i>), stafi shprehet se jo gjithnjë tema e diplomës është zgjedhja më e mirë për diplomimin, ata do të donin që kjo të ndryshonte në varësi të nxjerrjes së një produkti cilësor lidhur me temën e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 10.1, Rregullore e tezës së diplomës.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>UAMD në statutin e tij ia kushton kreun VII sigurimit të cilësisë. Ai ngre KSBC (komisionin) i cili është përgjegjës për garantimin e cilësisë si dhe strukturën ndihmëse akademike në varësi të rektoratit, NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) (neni 80, 81).</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti UAMD, neni 80 dhe 81.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	NJSBC ka për funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e KSBC për garantimin e sandardeve të cilësisë së brendshme dhe kurrikulave. KSBC ka detyrën të vlerësojë vazhdimisht programet, veprimtaritë mësimore, të ndjekë politikat e hartuara nga senati, etj.

	<i>Evidenca 2, Statuti UAMD, neni 80.</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat drejtuese, FB dhe Departamenti i Turizmit, janë në mbështetje të metodave të reja dhe inovative në mësimdhënie. Nga taikimi në institucion me pedagogët u pa se stafi, aty ku është e mundur, përpiqet të përdorë teknologjitë e informacionit, internetin, softëare të lidhur me degën, etj. Gjithashtu strukturat e matjes së cilësisë i kushtojnë rëndësi gjatë procesit të vlerësimit pasi pika 9 dhe 10 në formularin e vlerësimit të lektorëve u drejton studentëve pyetje lidhur me metodat alternative në mësimdhënie dhe nxitjen e diskutimeve dhe debateve. Megjithatë eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja nuk është në qendër të procesit. Pra, pranimi dhe përpjekja për të zbatuar metodat e reja, është hapi i parë, por më shumë duhet bërë për të nxitur eksperimentimin, që do të thotë proaktivitet në procesin e inovacionit në mësimdhënie. Në këtë rast do të ishte me vend që këto aspekte jo vetëm të përfshiheshin në strategjitë përkatëse, por edhe të punohej për zbatimin e metodave alternative, së pari duke identifikuar praktikat ndërkombëtare në këtë drejtim, e më pas duke planifikuar zbatimin dhe pasqyruar në çdo syllabus.</p> <p><i>Evidenca 44, Vlerësimi i lektorëve të brendshëm.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e CV të stafit akademik të departamentit mund të themi se ka ndryshime në kualifikimet e tyre primare, diploma dhe doktorata me diplomën aktuale ku kontribuojnë në mësimdhënie. Gjithashtu ka përpjekje për trajnime dhe kualifikime në fushën e turizmit gjatë kohëve të fundit si dhe pjesëmarrje në projekte, por ka një qasje në disa raste jo të duhur lidhur me kërkimin shkencor, ku një pedagog ka artikuj në fusha krejt të ndryshme si fusha shëndetësore, të palidhura me turizmin, por nga ana tjetër edhe artikujt për turizmin janë në një linjë krejt të ndryshme. Sigurisht fusha të lidhura mund të gjenden edhe në turizëm, lidhur me mjedisin, por ideja themelore e këtij masteri është drejtimi i ndërmarrjeve turistike, prandaj edhe kualifikimet e mëtejshme dhe kërkimi shkencor duhet të përqendrohet në këto fusha për të qenë më afër lëndëve dhe mësimdhënies në këtë master. Gjithashtu ka edhe pedagogë të cilët nuk kanë bërë kualifikime dhe bazojnë mësimdhënien në eksperiencën profesionale, e cila vlerësohet nga studentët, por nga ana tjetër nuk krijon kushte për kualifikim dhe zhvillim të mëtejshëm të diplomës. Në përmbledhjen e fushave të studimit të stafit, fokusi më i madh është tek rajonizimi ekonomik dhe gjeografia turistike</p>

	<p>dhe trashëgimia kulturore ndërkohë që i jepet më pak rëndësi fushave të menaxhimit të ndërmarrjeve turistike.</p> <p><i>Evidenca 20, CV stafi akademik i departamentit të turizmit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimet e stafit janë më tepër të mbështetura nga përpjekjet individuale, por ka një përpjekje të strukturave dhe njësite kryesore për të mbështetur stafin në trajnime si ato të programit Erasmus +, të cilat shërbejnë për kualifikimin e stafit.</p> <p><i>Evidenca 73.1, Tabelë përmbledhëse me mobilitete stafi DT.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik për zbatimin e programeve është maksimal. Nga ana tjetër ata përpjekin për përmirësimin e mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e literaturave të reja dhe mundësisht më të fundit dhe gjithashtu duke angazhuar në diskutime me studentët dhe në përpjekje për të përdorur teknologjitë e reja në mësimdhënie. Ata marrin parasysh rezultatet e anketave të studentëve.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i> <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Nga përpjekja për të përdorur metoda të reja në mësimdhënie dhe deri në testimin e tyre, rruga është e gjatë dhe nuk ka konkretisht analiza që të evidentojnë efektet e përdorimit të këtyre metodave.</p> <p><i>Evidenca 38, Analiza vjetore dep. Turizmit 2018-2019.</i> <i>Evidenca 38.1, Analiza e Departamentit për programin e studimit MP DNT.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni përfshin partnerë të ndryshëm përmes disa marrëveshjeve të bashkëpunimit. Megjithatë ka ende disa marrëveshje të identifikuara që janë në proces dhe nuk kanë dhënë rezultatet e planifikuara lidhur me bashkëpunimet. Gjatë vizitës në institucion, takimi me përgjegjës të departamentit dhe dekanin u evidentua se këto nuk janë realizuar sepse vetë departamenti kërkon të realizohen në formën e aktiviteteve publike ku të përfshihen dhe studentët dhe të jenë pjesë e promovimit të diplomës dhe departamentit dhe kjo nuk ka arritur të realizohet për shkak të impenjimeve të palëve. Megjithatë, këto përpjekje si edhe të tjera nuk identifikojnë angazhimin e duhur të lektorëve dhe kërkuesve për shkëmbimin e ideve. Kjo duhet të jetë një nga efektet e këtyre marrëveshjeve në të ardhmen.</p>

	<p><i>Evidenca 34, Marrëveshje bashkëpunimi UAMD.</i>  <i>Evidenca 34.1, Marrëveshje bashkëpunimi me universitete.</i>  <i>Evidenca 35, Raport mbi marreveshjet e bashkëpunimit.</i>  <i>Vizita në IAL, Takimi me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësën e Departamentit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>		

<b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në dosjen e programit. Ato njihen nga studentët përmes njohjes së rregullores si dhe prezantimit të syllabuseve në fillim të semestrave përkatës.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>  <i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Duke qenë se metodat e vlerësimit gjenden të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, këto syllabuse prezantohen tek studentët në fillim të semestrit. Nuk ka metoda të përdorimit të teknologjisë, pra Sistem Informacioni ku këto të dhëna të aksesohen dhe gjykojmë se çuarja në një nivel më të lartë përmes sistemit të planifikuar, do të bëjë të mundur rritjen e cilësisë nëpërmjet informimit të studentëve përmes teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe</p>	<p>Ka disa forma për vlerësimin e dijeve, të cilat përfshijnë provim të ndërmjetëm, provim final dhe kryesisht 10% forma të ndryshme të vlerësimit përmes detyrave, projekteve, eseve, seminareve etj. GVJ gjithsesi mendon se rëndësia dhe ndikimi i formave të ndryshme të vlerësimit do të ishte më e madhe, nëse</p>

kompetencat e fituara.	<p>pesha e tyre në vlerësimin përfundimtar do të ishte më e madhe, pasi mbetet fakti që 90% e vlerësimit bëhet përmes dy provimeve.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që realizohet gjatë gjithë vitit akademik të cilat dhe reflektohen në vlerësimin përfundimtar, me një peshë prej 10% janë kryesisht detyra/projekte.</p> <p>Testimi i dijeve dhe njohurive do të ishte më i mirëreflektuar në vlerësimin përfundimtar me një peshë më të lartë, kështu do të mund gjithashtu të testoheshin më tepër aftësi, si psh, aftësi të analizave të rasteve, aftësi për prezantime dhe vlerësime të situatave, aftësi të punës në grup dhe komunikimit, të cilat nuk mund të vlerësohen vetëm përmes provimit përfundimtar. Përfshirja e kategorisë së seminareve përveç detyrave do të ishte në këtë rast më produktive.</p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në programin e studimit nuk përdoren format elektronike të vlerësimit.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe</p>	<p>Sipas rregullores së provimeve, testimi i vlerësimi përfundimtar</p>

<p>aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>realizohet nga komisionet e provimeve me 3 anëtarë.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Konfirmuar edhe nga Rregullorja e Programit të Studimit, të gjitha format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit. Ky proces kryhet nga Koordinator i Departmentit dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p>Proceset e kontrollit të dijes zhvillohen konform të gjitha rregullave institucionale.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Duke iu referuar RVB, faqe 40, standardi III.6, kriteri 5 komentet dhe feedback lidhur me këshillat mbi procesin e të nxënësve, konceptohen nga institucioni për sa i përket pjesës së provimit. Referuar rregullores së provimeve dhe rregullore të FB e Departmentit, citohet procesi i ankimit, shënimet e pedagogëve tek provimet dhe sqarimi lidhur me vlerësimin. Ky është një proces i drejtë dhe i domosdoshëm, por nga ana tjetër duhet të merret parasysh feedback edhe përpara vlerësimit përfundimtar, që do të thotë pjesa e vlerësimit përgjatë semestrit dhe dhënia e feedback studentëve lidhur me gjithë procesin. Evidentimi i komenteve dhe feedback lidhur me format e vlerësimit të njohurive besojmë se duhet të jetë një pikë ku programi të fokusohet në të ardhmen në dokumentat themelore të rregullores së programit, formularëve të vlerësimit si edhe aspekteve të vlerësimit të stafit.</p> <p><i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 6.1, Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i>  <i>Evidenca 21, Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Evitimi dhe moslejimi i plagjiaturës është parim i pranuar në dokumentat kryesore të UAMD. Gjithashtu, secili pedagog përcakton penalizim në rast të plagjiaturës dhe kopjimit në dokumentin e syllabusit.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e re UAMD.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 21, Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në</p>	<p>Rregulloret përkatëse të programit të studimit paraqesin mënyrën e dhënies së rezultateve të konotrollit të dijeve dhe nga vizita në</p>

<p>rregulloret përkatëse.</p>	<p>institucion, në takimin me pedagogët e programit të studimit, shihet se pedagogët e programit dhe njësia përgjegjëse, Departamenti i Turizmit zbaton rregulloret për provimet në mënyrë rigorozë. Dhënia e vlerësimeve bazuar mbi meritën realizohet përmes tezave të provimit përfaqësuese, të firmosura nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e re UAMD.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 21, Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Të drejtat e studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim garantohehen nga rregullorja e provimeve, si dhe rregulloret në nivel institucioni dhe fakulteti.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e re UAMD.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 21, Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>E drejta e ankimimit të studentit për vlerësimin e provimit gjithashtu garantohehet nga rregulloret e institucionit në të gjitha nivelet. Procedura e ankimimit është gjithashtu e mirëpërcaktuar dhe përfshin komisionin e rivlerësimit dhe dokumentimin e gjithë veprimeve të ndërmarra, nga përgjegjësi i departamentit dhe komisioni i rivlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e re UAMD.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 21, Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit përpiqet të zhvillohet duke kërkuar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale, duke sugjeruar një sërë lëndësh, si komunikimi dhe marketing i turizmit, mikpritje dhe menaxhim hotelier, industria turistike dhe organizimi, ICT në turizëm, Analiza e kostove, Menaxhim i burimeve njerëzore. Gjykojmë se më shumë mundësi ka që</p>

	<p>studenti të marrë aftësi të përgjithshme, se sa ato të veçanta, pasi edhe lëndët e përfshira nuk mund të aftësojnë specifikisht, por duke u përpjekur tu japin studentëve një gamë të gjerë njohurish. Kjo nuk i fokuson, por i shpërndan lidhur me profesionin dhe orientimin e tyre drejt menaxhimit të ndërmarrjeve.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit përmban një lëndë që aftëson drejtpërdrejt me ICT (teknologjitë e informacionit dhe komunikimit). Lënda sidoqoftë nuk përmban laboratore, pra aftësi praktike lidhur me ICT dhe ka shumë pak pjesë të programit të lidhur me turizmin dhe zhvillimet më të fundit të teknologjisë, rrjetet sociale dhe internet, në funksion të turizmit. Në disa lëndëm sipas takimit në institucion, stafi përpiqet për të njohur studentët me aspekte të teknologjisë të përdorura në turizëm, si procesi i rezervimit. Megjithatë, këto nuk janë formale përgjatë programeve dhe syllabuseve të lëndëve dhe mbeten të paformalizuara për programin e studimit. Ai nuk përmban njohuri të gjuhëve të huaja, duke qenë në nivel master profesional, pra, nuk ka nevojë të aplikohen në këtë rast. Ka një lëndë që fokusohet tek marketing dhe komunikimi, që jep njohuri dhe aftësi lidhur me komunikimin. Aftësi më të thelluara lidhur me aspektet e specifikave të menaxhimit në turizëm dhe lidhjes së ndërmarrjeve të turizmit me fushën e shkencave humane e sociale mund të sugjerohen për tu përfshirë në temat e lëndëve të programit.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti mund të shqyrtohen vetëm përmes procesit të vlerësimit. Ka gjithashtu një raport të ecurisë së studentëve nga pikëpamja e mesatares në hyrje dhe asaj në dalje, ku shohim se një pjesë e studentëve janë</p>



	<p>ngritur në nivelin e tyre duke u nisur nga mesatarja. Gjithashtu shihet se një pjesë e studentëve, kanë qenë të punësuar para dhe gjatë programit të studimit, ndërsa pjesa tjetër janë punësuar. Nuk ka forma të tjera të analizës së aftësive të fituara.</p> <p><i>Evidenca 27, Ecuria e studentëve.</i> <i>Evidenca 29, Punësimi i studentëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve shohim se vetëm në disa prej tyre ka orë përfundimtare të kushtuara përsëritjes dhe orientimit të studentëve për provimin përfundimtar. Realizimi i këtyre orientimeve dhe mospasqyrimi i tyre në syllabus mund të ndodhë, por gjithë stafi duhet të garantojë në të ardhmen evidentim të orëve orientuese dhe përmbledhëse për studentët për implementimin e çështjeve më të rëndësishme dhe testin përfundimtar.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i> <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i> <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i> <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Nuk janë realizuar ekzaktësisht orë të hapura, por janë realizuar në kuadër të marrëveshjeve disa vizita studimore në institucione të ndryshme të konsideruara me rëndësi për programin e studimit. GVJ gjykon se më shumë ndërveprim në këtë aspekt do të duhej të kishte me operatorët e industrisë, duke qenë se programi master është menaxhim i ndërmarrjeve turistike dhe nuk është specifikisht i lidhur me pjesën e muzeve, apo të trashëgimisë, ose menaxhimin publik në turizëm, ku janë të vendosura edhe aktivitetet e pasqyruara nga departamenti në evidencë.</p> <p><i>Evidenca 35, Raport mbi marrëveshjet.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Duke gjykuar syllabuset, përmbajtjen e lëndëve, mendojmë se kompetencat që marrin studentët, i orientojnë ata në procesin e mëtejshëm të praktikave profesionale. Programi i studimit përmban njohuri për fusha të ndryshme, ku studenti mund ta gjejë veten në praktikë në të ardhmen. Nuk kemi një feedback nga studentët se sa orientues mund të jetë ky program për fushat brenda ndërmarrjeve turistike ku studenti mund të gjejë veten apo për tipet e ndërmarrjeve ku ai do të përfshihet përmes proceseve</p>

	<p>menaxheriale.</p> <p><i>Evidenca 14, Dosja e plotë e programit të studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i></p> <p><i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik, duke u bazuar në vizitën në institucion, takimet me përgjegjësin e departamentit, dekanin dhe stafin akademik, është më tepër i angazhuar në zbatueshmërinë e rregulloreve dhe realizimin e mbledhjeve të stafit akademik, bazuar në nevojat e punës së përditshme, por nuk u identifikua ndonjë situatë ku të shihet frymë grupi në zgjidhjen e problematikave.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, takimi me stafin akademik të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Një klimë e përshtatshme në zhvillimin e ideve inovative, do të ishte rasti kur nxitet pjesëmarrja në mbledhje apo diskutime për prezantimin e ideve të tilla gjatë procesit të mësimdhënies ose dhe në kërkimin shkencor, kur departamenti krijon grupe pune për sjelljen dhe analizën e praktikave më të mira, kur shkëmben eksperiencë me staf të fakulteteve të tjera, apo institucioneve të lidhura për ide novatore lidhur me studime, përfshirje të studentëve, etj. Përpjekjet për këtë i shohim vetëm në rastin e krijimit të marrëveshjeve, të cilat edhe ato nuk janë konkluduar të gjitha.</p> <p><i>Evidenca 34, Marrëveshje bashkëpunimi UAMD.</i></p> <p><i>Evidenca 34.1, Marrëveshje bashkëpunimi me universitete.</i></p> <p><i>Evidenca 35, Raport mbi marreveshjet e bashkëpunimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UAMD, Fakulteti i Biznesit me përfshirjen edhe të Dep. të Turizmit, ka realizuar konferencat studentore. Megjithatë studentë nga ky master nuk kanë marrë pjesë aktive. Ky kriter nuk është plotësisht i aplikueshëm për këtë program, duke qenë një program i masterit profesional, fokusi i studentëve nuk është puna kërkimore shkencore, por dalja në profesion në tregun e punës.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti nuk kanë bërë ndonjë hap konkret për</p>

<p>ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>të ndërthurur punën me institucione të tjera bashkëpunuese për rritjen e mobilitetit të studentëve. Zyrtarisht ekziston lista e institucioneve të bashkëpunimit me universitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit dhe përmendet në analizën e Marrëveshjeve, por nuk ka patur mobilitete të studentëve në këtë program.</p> <p><i>Evidenca 34, Marrëveshje Bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 34.2, MoU UAMD.</i>  <i>Evidenca 73.1, Tabelë përmbledhëse me mobilitete stafi DT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse garantojnë marrëveshje me institucione që studentët të realizojnë praktikën mësimore. Megjithatë ka dy momente. Së pari, sipas rregullores së praktikës, institucioni e lë gjithashtu në zgjedhjen e studentit vendin e praktikës dhe kur ai nuk mund të gjejë atë, atëherë institucioni përpiqet përmes marrëveshjeve apo dhe institucioneve të tjera me të cilat nuk ka marrëveshje.</p> <p>Momenti i dytë është se departamenti dhe FB kanë marrëveshje kryesisht me institucione shtetërore apo publike dhe shumë pak me institucione private, të cilat do të duhet të ishin shumë më në fokus për programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 10.3, Rregullore e praktikës.</i>  <i>Evidenca 35, Raport Analitik mbi Marrëveshjet e Bashkëpunimit DT.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve</p>	<p>Praktika profesionale ka 3 kredite dhe ka një sërë dokumentash të cilat përcaktohen në rregulloren e praktikës dhe gjithashtu janë vënë në dispozicion nga departamenti. Këto dokumenta paraqiten dhe dorëzohen nga studenti ndërkohë që janë ndjekur nga</p>

dhe vlerësimin përkatës.	pedagogu përgjegjës për praktikën dhe gjithashtu përmbajnë vlerësimin përkatës të mbikëqyrësit në vendin e praktikës.  <i>Evidenca 10.3, Rregullore e praktikës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.9</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. Kjo përcaktohet në rregulloren e diplomimit. Departamenti është bërë me dije në mbledhjet e departamentit dhe komunikime.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Rregullorja e diplomimit përmban edhe mënyrën se si personeli akademik asiston studentët në funksion të provimit final ose diplomimit.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Këtu bëhet fjalë për ata studentë të cilët e zhvillojnë provimin përfundimtar me tezë provimi. Këta i referohen nenit 12 në rregulloren e diplomimit.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i> <i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nuk përcaktohet specifikisht se si personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit. Pra, kjo nuk është kërkesë e rregulloreve.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Asistenca e institucionit në matje dhe analiza nuk përfshihet në asnjë pikë të rregullores lidhur me diplomimin dhe temën e diplomës.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i> <i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i>

<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Detyrat dhe roli i udhëheqësit të diplomës është subjekt i nenit 5 të rregullores së diplomimit. Vetëm pika 4 jep rolin këshillues të udhëheqësit, pa detruar këtë rol, sipas këtij kriteri. Evidenca 10.1 rregullore e tezës së diplomës, jep përgjegjësitë e udhëheqësit në nenin 3, ku në pikën 4 jepet roli i tij si konsulent duke u bazuar në kriterin 6.</p> <p><i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i> <i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i diplomës është subjekt i nenit 11 të rregullores së diplomimit, ku procesi dhe mënyra e vlerësimit është shumë e qartë dhe e specifikuar. Gjithashtu vlerësimi paraqitet dhe në kreun II të rregullores për tezën e diplomës. Përsëritjet që ekzistojnë midis këtyre rregulloreve duhet të evitohen, ose këto rregullore të bashkohen në një të vetme, pasi nuk ka pse të ketë rregullore për diplomimin si proces dhe tezën e diplomës, më vete.</p> <p><i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i> <i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar mbi të gjithë bazën e legjislacionit në fuqi dhe dokumentet bazë të statutit, rregulloreve në tre nivelet, në fund të studimeve studenti pajiset me diplomë. Diploma e programit MP në DNT ka suplementin e saj, por ka probleme lidhur me përkthimin e gabuar të titullit në anglisht të suplementit, burim nga stafi i departamentit. Kjo problematikë u identifikua nga GVJ dhe u bë me dije nga GVB dhe përfaqësues të institucionit se miratimi është bërë nga QSHA, me propozimin e departamentit dhe çdo kërkesë për ndryshim duhet t'i drejtohet këtij Institucioni. U tha gjithashtu që do të bëhet kërkesë për ndryshimin e emërimit në anglisht.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i> <i>Evidenca 5, Rregullore e Universitetit.</i> <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 6.1, Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar dhe kjo shprehet në rregulloren e programit të studimit dhe atë të diplomimit, si dhe në Modelin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i></p>

	<i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i> <i>Evidenca 15, Modeli i diplomës.</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Institucioni jo vetëm ruan kopjet e dorëzuara të diplomave, por gjithashtu i ruan ato on-line duke i bërë edhe publike për audiencën e interesuar. Periudha e ruajtjes është e pacaktuar. Informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, nëse kërkohen.  <i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i> <i>Evidenca 10.1, Rregullore e diplomimit.</i> <i>Evidenca 15, Modeli i diplomës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	UAMD mban të dhënat e personelit akademik të programit të studimit dhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, në zyrën e burimeve njerëzore, ku GVJ pati mundësinë të aksesojë të dhënat e dosjeve duke përzgjedhur dy dosje PAE dhe një dosje PAK ( <i>për shkak se një i vetëm është personeli PAK në këtë program</i> ). Për stafin PAE 1 dosja përmbante: formular aplikimi, CV, diploma dhe vërtetime të përfundimit të shkollës së lartë, kualifikime kompjuterike, fotokopje të kartës së identitetit, cikël leksionesh të pedagogut, përmbledhje në slide të temës së doktoratës të mbrojtur nga pedagogu, certifikata pjesëmarrje në konferenca të ndryshme. Për stafin PAE 2 dosja përmbante: formular aplikimi, CV, diploma të shkollës së lartë, fotokopje të kartës së identitetit, letër rekomandimi, vërtetim pune, dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj, vërtetim i gjendjes gjyqësore, kërkesë punësimi, certifikata kualifikimi dhe pjesëmarrjeje në konferenca të ndryshme. Për

	<p>stafin PAK, dosja përmbante: formular aplikimi, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmia e marrjes së gradës shkencore “Doktor” dhe titullit “Profesor i Asociuar”, CV dhe vërtetim pune. Gjithashtu evidenca 69 lidhet me mbajtjen e të dhënave të stafit akademik lidhur me angazhimin e tyre vjetor.</p> <p>Evidenca e rregullores së burimeve njerëzore tregon procedurat dhe detyrimet për ruajtjen e të dhënave të personelit.</p> <p><i>Evidenca 11, Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore.</i>  <i>Evidenca 69, Marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet përgjegjësit të departamentit-lektor.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar rregullores së UAMD ka parashikuar procedurat për rekrutimin e personelit.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në terren përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vakant, vendosja e kriterëve të pranimit në përputhje me kërkesat për realizimin e ngarkesës mësimore dhe punës kërkimore shkencore, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. Edhe personeli akademik me kontratë i nënshtrohet procesit, përveç pjesës së intervistës.</p> <p>Shpallja e vendit vakant bëhet përmes faqes së web dhe çdo kërkesë, pyetje apo komunikim bëhet gjithashtu përmes e-mailit zyrtar të vendosur në website.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e UAMD.</i>  <i>Evidenca 110, Procedura për rekrutim.</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kriterëve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan departamenti sipas nevojave të tij për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Kriteret e përgjithshme janë të vendosura në <i>evidencën 110</i>. Në dokumentin “<i>Memo kriteret për PAK për vitin akademik 2019-2020</i>”, IAL, ka paraqitur kriteret specifike të vendosura nga departamenti për stafin PAK, për këtë vit akademik.</p> <p><i>Evidenca 110, Procedura për rekrutim.</i>  <i>Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL, Memo kriteret për PAK, v.a 19-</i></p>

	20.			
<b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga vizita në institucion gjithashtu u kërkua një argumentim nëse thirrjet për pedagogë efektivë por edhe të jashtëm bëhen me kriteret specifike, që lidhin degën e turizmit apo jo. Në dokumentin “Memo kriteret për PAK për vitin akademik 2019-2020”, IAL, ka paraqitur kriteret specifike të vendosura nga departamenti për stafin PAK, për këtë vit akademik. Në fakt ka mungesë aktualisht të stafëve të diplomuara në degën e turizmit si PAE ashtu edhe PAK.  <i>Vizita në IAL, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore. Evidenca e marrë gjatë vizitës në IAL, Memo kriteret për PAK, v.a 19-20.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Krijimi i mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit, përfaqësohet nga nivelet drejtuese të institucionit në përgjithësi dhe nga nivelet drejtuese të departamentit në veçanti. Në të gjitha dokumentet strategjike bazë, Statuti, Strategjia, rregullorja e UAMD, shprehet garancia për lirinë akademike të pedagogut dhe për cilësinë e lartë në proceset akademike dhe infrastrukturës së institucionit, krijimin e një mjedisi nxitës, bashkëpunues dhe zhvillues për profesoratin, studentët dhe stafin. Institucioni gjithashtu angazhohet për vlerësimin e drejtë të stafit akademik, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe zyrës së sigurimit të cilësisë, duke bazuar veprimtarinë në matjen e performancës.  Informimi është një pikë tjetër e rëndësishme lidhur me mundësitë që ofrohen nga UAMD për projekte, kërkim shkencor dhe zhvillim, që krijojnë barazi dhe oportunitete të njëjta për studentët dhe personelin.  <i>Evidenca 2, Statuti i UAMD. Evidenca 5, Rregullore UAMD. Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>



	<p><i>Evidenca 54, Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni shpërndan informacion për mundësitë e kualifikimit brenda dhe jashtë vendit. Por jo të gjithë pedagogët i kanë shfrytëzuar mundësitë sipas informacioneve të shpërndara.</p> <p>Pedagogë në programin e studimit kanë përfituar bursa Erasmus (Evidenca 73.1), por kjo duhet të shtrihet për të gjithë pedagogët e programit. Gjithashtu angazhim më i madh në vlerësimin nga pikëpamja institucionale, brenda departamentit e fakultetit për pedagogët të cilët marrin kualifikime, do t'i nxiste ata që të kërkojnë kualifikim të vazhdueshëm. Nga vizita në institucion me zyrën e projekteve doli në pah se pavarësisht projekteve dhe marrëveshjeve në nivel institucioni apo fakulteti, këto nuk kanë shërbyer për programin e studimit në fjalë. Duke qenë se drejtoria e projekteve është e re, e krijuar në 2018, argumentohet se ka punuar vetëm në rang IAL për realizimin e marrëveshjeve dhe jo në rang departamenti. Këtu sugjerojmë që departamenti duhet të mbajë marrëdhënie të ngushta me drejtorinë, por edhe në linjën hierarkike të autoriteteve dhe organeve drejtuese, të kërkojë një shërbim më të madh nga drejtoria e projekteve, pasi fusha e turizmit është një nga fushat prioritare për projekte të kërkimit shkencor në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, por gjithashtu edhe për vendosjen e marrëveshjeve të bashkepunimit.</p> <p><i>Evidenca 73.1, Tabelë përmbledhëse me mobilitete stafi DT.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nuk ka programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies, të cilat të ofrohen në mënyrë zyrtare nga institucioni, apo të ketë bashkëpunime të institucionit në këtë kuadër. GVJ sugjeron fort që kjo të përmirësohet në të ardhmen, që të mos lihet thjesht në kuadër të dëshirës apo nevojës që vetë stafi ndjen për të përdorur metoda inovative dhe teknologji, por të punohet me sistemet e-learning, me metodat bashkëvepruese, etj</p> <p><i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p> <p><i>Evidenca 6.1, Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i></p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 54, Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD.</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Angazhimi i burimeve njerëzore është brenda kufijve të pranueshëm sa i përket numrit, kohës së angazhuar dhe ngarkesës mësimore për arritjen e objektivave të programit. Ka gjithashtu përpjekje për përfshirje në zhvillimin e burimeve njerëzore për të ofruar shërbim më të mirë për studentët. Ajo që krijon problem është një shpërndarje në ndonjë rast jo e duhur e ngarkesave mësimore sipas kualifikimeve në lëndët përkatëse të stafit të departamentit.</p> <p><i>Evidenca 20, CV e stafit.</i>  <i>Evidenca 25, Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik për programin e studimit (risjellë në dokumentat e kërkuara gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i marrë gjatë vizitës në IAL, ngarkesa PAE dhe PAK për sem I-rë dhe parashikimi për sem II-të, v.a 2019-2020.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Ambjentet fizike përbëhen nga salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve të programit. Numri i sallave në dispozicion dhe hapësirat përkatëse janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Studentët dhe pedagogët kanë akses në mjediset e bibliotekës, ku ka hapësira të bollshme.</p> <p><i>Evidenca 42, Të dhëna për Infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i>  <i>Vizita në IAL, Vëzhgimi i ambienteve të Institucionit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Çdo sallë e leksioneve është pajisur me mjete projektorë duke mundësuar prezantimet e leksioneve në PPT. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Situata është relativisht e kënaqshme për realizimin e orëve mësimore të lidhura me teknologjinë sa u përket pajisjeve dhe infrastrukturës.</p> <p><i>Evidenca 42, Të dhëna për Infrastrukturën në funksion të programit të</i></p>

	<i>studimit.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sipas vizitave në institucion u pa se laboratorët janë të përshtatshëm për realizimin e orëve në raste të nevojshme për programin e studimit. Nuk ka akses në programe të cilat mund ti shërbejnë specifiku degës dhe nga takimet me pedagogët e programit, del se mund të përmirësojnë në aplikimin e programeve të cilët kanë lidhje me proceset në ndërmarrjet turistike, rezervimi, menaxhimi i brendshëm, etj.			
	<i>Evidenca 42, Të dhëna për Infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i>			
	<i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Institucioni ka laborator të teknologjisë së informacionit ku studentët e programit mund të kenë akses, por nuk ka programe profesionale të natyrës së programit të studimit. Ky aspekt duhet të përmbushet në të ardhmen pasi sot të gjitha operacionet në ndërmarrjet turistike ofrohen me mbështetjen themelore të këtyre programeve dhe teknologjisë në përgjithësi. Nuk mund të konceptohet menaxhimi i tyre pa njohjen e aspekteve të programeve dhe teknologjive mbështetëse.			
	<i>Evidenca 42, Të dhëna për Infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i>			
	<i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale bazuar vetëm në marrëveshje me institucionet dhe operatorët në treg. Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet sipas një procedure të qartë të përmendur më lart, në standardin II.5, kriteri 4 dhe që garanton realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Institucioni dhe departamenti është përgjegjës për ndjekjen e pjesës së praktikës.			
	<i>Evidenca 64, Shembull i kryerjes së praktikave profesionale DT.</i>			
	<i>Evidenca 86.1, Rregullorja mbi organizimin e udhëtimit mësimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.4**  
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Siç u përmend edhe në Standardin IV.3, kriteri 2 dhe 3, duke qenë se biblioteka është pjesë përbërëse e mjediseve të UAMD, mundësitë e shfrytëzimit të bibliotekës janë të barabarta për të gjithë studentët. Nga vizita u vu re se biblioteka frekuentohej nga studentët, duke shfrytëzuar të gjitha mjediset e saj.</p> <p>Biblioteka përmban literaturë të nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit, por literatura në shqip, përveç cikleve të leksioneve, nuk është literaturë e 5 viteve të fundit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standardeve të bibliotekave, ka punonjës të trajnuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave.</p> <p>Gjithashtu në titujt në gjuhë të huaj vihet re një numër ri madh titujsh në fushën e financës dhe një numër shumë i vogël për turizmin.</p> <p>Titujt shqip për programin e studimit janë të kufizuar, megjithëse ka një numër të titujve në shqip që janë botuar në të kaluarën.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimet me stafin, ata i kërkojnë bibliotekës titujt të cilat janë kryesorë në syllabus. Por aktualisht programi duhet të fokusohet sidomos në titujt në Shqip për lëndët karakterizuese dhe lëndët bazë, për të cilat mund të bashkëpunohet për përkthimin në programin Cleanscore.</p> <p><i>Evidenca 42.2, Të dhëna për infrastrukturën (Plani strategjik biblioteka-2015-2020).</i></p> <p><i>Evidenca 45, Lista kryesore e artikujve të hedhur në katalogun e bibliotekës, profili ekonomi-turizëm.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Siç u përmend më sipër Biblioteka u jep mundësi të gjithë studentëve të aksesojnë në bibliotekat online pa pagesë, përmes kompjuterave të vendosur aty. Aksesit në biblioteka online përveç programit mbështetës të MASR duhet të merret parasysh për të ardhmen në UAMD.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe lidhje internet, përmes të cilave mund të aksesohet në librarinë elektronike të ofruar sot në universitetet publike përmes ministrisë së arsimit.</p> <p>Programet kompjuterike dhe pajisjet teknike janë në nivele të kënaqshme në përgjithësi dhe në dispozicion të programit të studimit për të gjithë studentët pa kufizime.</p> <p><i>Vizita në IAL, vizita në bibliotekë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të</p>	<p>Ka një plan strategjik për bibliotekën por duhet marrë parasysh se</p>

<p>hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>shtimi i zërave dhe fondit ekzistues kërkon gjithashtu buxhetin e duhur nga institucioni. Plani strategjik merr parasysh bashkëveprimin me stafin akademik, por nuk përfshin një plan veprimi taktik dhe me afate e buxhete konkrete të parashikuara për shtimin e zërave të bibliotekës. Kjo duhet të kërkohej nga stafi akademik, nga drejtuesit e njëjësive duke u percjellë në nivelet drejtuese dhe vendimmarrëse për buxhetin e bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca 42.2, Të dhëna për infrastrukturën (Plani strategjik biblioteka-2015-2020).</i></p> <p><i>Evidenca 45, Lista kryesore e artikujve të hedhur në katalogun e bibliotekës, profili ekonomi-turizëm.</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në oraret e qëndrimit të studentit në universitet. Gjatë sezonit të provimeve orari i bibliotekës është më i zgjatur. Kapacitetet e bibliotekës me sallën përkatëse janë të përshtatshme dhe në mbështetje të zhvillimit të procesit mësimor, numrit të studentëve.</p> <p><i>Vizita në IAL, vizita në bibliotekë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në UAMD për disa vite ka ekzistuar sistemi AULA. Sipas takimeve në institucion, me NJSBC, thuhet se vitin e kaluar është futur sistemi i RASH-it, të cilët janë duke punuar për një sistem të ri që do jetë për të gjitha IAL-të. Si rrjedhim, AULA ka ndaluar funksionimin në pritje për të zbatuar të parët sistemin e ri. Por theksojmë se ky sistem nuk ka mbështetur programin e studimit aktual, por vetëm programet dy-vjeçare të studimit.</p> <p><i>Evidenca 46, Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë Manual_Aula.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin</p>	<p>Sistemi Pitagora gjithashtu funksionon për hedhjen e notave dhe studentët aksesojnë për t'i marrë ato.</p>


dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Theksojmë se programi është vetëm për Bsc., jo për masterin. Pra, në këtë program studimi nuk aplikohet.</p> <p><i>Evidenca 46, Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë Manual_Aula.</i></p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Ky program studimi nuk ka akses në sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe si rrjedhim nuk ka akses të dedikuar në informacione e dokumente për personelin, studentët etj.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Ky program studimi nuk ka akses në sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe si rrjedhim nuk mundëson forma komunikimi interaktiv, etj.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Nuk ka sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit për këtë program studimi, prandaj nuk ka monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>Në faqen e internetit publikohen informacionet lidhur me programin, aktivitetet e ndryshme dhe personelin akademik.</p> <p><a href="https://ëëë.uamd.edu.al/index.php/sq/">https://ëëë.uamd.edu.al/index.php/sq/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		<b>X</b>		

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme	Ka një raport të elementeve që ndikojnë tek kosto e programit të studimit, por nuk ka analizë të mirëfilltë dhe raport financiar të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



<p>për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>kostove për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 49, Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës aksesin në bibliotekat on-line, detyrimin financiar, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Duke qenë IAL publike, analizat financiare bëhen në nivel institucioni dhe nuk ka një praktikë për realizimin e analizave financiare në nivel programi studimi. Përmbushja e këtij kriteri nuk merret parasysh në IAL në përgjithësi, në nivelin e programeve të studimit.</p> <p>Kjo krijon problem lidhur me analizën në aspekt financiar të produktit që ofrojnë IAL-të.</p> <p>Gjithashtu institucioni nuk ka fituar grante të lidhura me këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 38.1, Analiza e Departamentit për programin e studimit MP DNT.</i></p> <p><i>Evidenca 49, Të dhëna nga raporti financiar vjetor institucional.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim bazuar në legjislacionin në fuqi, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Auditimi në 5 vitet e kaluara është bërë nga njësi audituese e ministrisë së financave dhe paraqitet në Evidencën 49.1, auditin financiar.</p> <p><i>Evidenca 49.1, Memo raport 5 vjeçar veprimtaria auditit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Duke qenë një program i ri studimi prej vetëm 1 viti, ky kriter duhet të zbatohet në fund të vitit akademik 2021. Sugjerojmë që të bëhet një analizë financiare për programin e studimit në bashkëpunim me departamentin e financës, që të përfshijë jo vetëm zërat e parashikuar në dosjen e hapjes së programit të studimit (aneksi 5) sipas evidencës 50, por të përfshihet gjithë informacioni mbi të ardhurat e pritshme dhe kosotot e detajuara dhe mënyra se si këto parashikohet të mbulohen.</p> <p><i>Evidenca 50, Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nuk kemi informacion të mjaftueshëm për të evidentuar përmbushjen e këtij kriteri. Numri i studentëve, aktualisht është shumë i ulët për programin e studimit për shkak të hapjes së tij shumë afër me fillimin akademik, pra kjo nuk garanton burim të ardhurash të mjaftueshme për programin. Kjo do të varet nga mundësia për të gjeneruar të ardhura nga vetë institucioni por sidomos për të tërhequr studentë në këtë program në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca 27, Të dhëna tabelare mbi regjistrimin, ecurinë, diplomimin e</i></p>

	<i>studentëve të MP DNT.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale e analitike.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës. Kriteret e pranimit gjithashtu përcaktohen në rregulloren e programit të studimit si edhe në njoftimet që bëhen përpara fillimit të vitit akademik në afatet e caktuara. Të gjitha procedurat e tjera, mësimdhënia, vlerësimi, provimet, zhvillimi i praktikave dhe diplomimi realizohen bazuar në legjislacionin në fuqi. Zyra e komunikimit, alumni dhe karrierës kontribuon në zbatimin e rregullore për aspektet e tërheqjes së studentëve përmes takimeve në shkollat e mesme.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>  <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe



	studentëve të programit.  <i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Departamenti i Turizmit, UAMD ka ndërtuar strategjinë për marketingun e programit dhe transparencën ku paraqet mënyrat se si programi, ku përfshihen dhe kriteret dhe procedurat e pranimit do të vijë për publikun. Njoftimet për kriteret e pranimit gjithashtu paraqiten në faqen e Internetit.  <i>Evidenca 51, Politika e marketingut të programit të studimit, format, transparenca me publikun.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Duke qenë se ky është viti i parë i vlerësimit të programit, dhe nuk ka më shumë se dy vjet që janë pranuar student, nuk mund të gjykojmë për ndryshimin e kriterëve, apo shtimin e kriterëve të tjera specifike për përzgjedhjen e kandidatëve. Por gjykojmë se këto kriteret duhet të përfshihen në të ardhmen.  <i>Evidenca 101, Kriteret për aplikimet e studentëve për Master Profesional.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Nga vizita në institucion doli se gjithë stafi i programit ka bërë shumë përpjekje për të promovuar programin, i cili u hap shumë afër afatit të fillimit të vitit akademik 2018-2019. Gjatë kësaj periudhe është komunikuar për kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe për objektivat dhe përfitimet nga programi.  <i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, takimi me stafin e programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit	Përparimi akademik i studentëve përgjatë vitit të vetëm akademik të programit, përcaktohet në rregulloren e programit, ku tregohen metodat e vlerësimit të dijeve, rastet kur nuk arrihet përmbushja e kriterëve për të kaluar provimin, rastet kur përsëritet provimi për

<p>akademik në tjetrin.</p>	<p>mosfrekuentim, rastet kur provimi jepet në vjeshtë dhe rastet e tjera që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të studentit për praktikat dhe diplomimin deri në finalizimin e studimeve.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e këtij programi nuk parashikohen raste kur studenti ka kualifikime të mëparshme që mund të njihen apo studime të pjesshme. Sugjerojmë që të parashikohet një nen edhe për raste të transferimeve.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve jepen në rregulloren e programit të studimit por edhe në syllabusin e secilës lëndë, i cili paraqet raportet e vlerësimit të dijeve sipas kategorive. Informimi i studentëve bëhet çdo fillim viti akademik mbi njohjen e rregullores dhe çdo fillim semestri për procedurat e vlerësimit të dijeve për secilën lëndë.</p> <p><i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i>  <i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i>  <i>Evidenca 19, Syllabuset e lëndëve.</i>  <i>Evidenca 67, Syllabuset e reja me ndryshime në vlerësim Mp DNT (risjellë në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në IAL).</i>  <i>Dokument i kërkuar gjatë vizitës në IAL, syllabuset MP DNT 2019-2020.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës janë të përcaktuara në rregulloren e diplomimit dhe studentëve iu bëhet me dije përmes udhëheqësve si dhe stafit ndihmës akademik të programit. Gjithashtu përmes komunikimeve me e-mail me studentët e programit, ata informohen mbi procedurat dhe çështje të tjera për të cilat pyesin.</p> <p><i>Evidenca 10, Rregullore e diplomës.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Gjatë vitit të parë informimi është bërë më tepër përmes kanaleve personale të komunikimit, ndërsa është ndërtuar tashmë një strategji për marketingun e programit që parashikon edhe takime të hapura për informim. Nga vizita në institucion gjithashtu u tha përmes zyrës së Alumni dhe karrierës se UAMD ka kontakte me të gjitha shkollat e mesme dhe bën një promovim të shtrirë në gjithë Shqipërinë, pjesë e të cilit sigurisht do të jetë edhe fakti se ka tashmë një program të MP DNT i cili plotëson ciklin e</p>

	studimeve për turizëm në UAMD. Aktualisht nuk mund të themi se janë zhvilluar takime të hapura për informim për programin, por secili kandidat kur nis procesin e regjistrimit për të konkurruar informohet nga stafet mbështetëse dhe stafi pedagogjik.			
	<i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Organizimi i studimeve në MP DNT është pjesë e kapitullit të dytë të rregullores së programit. Në nenin 5 jepet kohëzgjatja e studimeve. Informacionet për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe programin supozohet të vihen në dispozicion të studentëve, por nuk ka ndonjë pikë në rregulloren e programit të studimit që të theksojë të drejtën e studentit për tu informuar mbi syllabusin ose detyrimin e pedagogut për të vënë në dispozicion syllabusin. Sipas takimit me studentët ata njihen në fillim të vitit me programin. Sugjerojmë që kjo pavarësisht se implikohet nga rregulloret e përgjithshme dhe bëhet nga stafi, të vendoset edhe në rregulloren e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i> <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik, takimi me studentët.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UAMD dhe specifikisht FB është përprekur të ndërtojë disa marrëveshje institucionale, për orientimin e studentëve në tregun e punës. Jo të gjitha marrëveshjet janë përfunduar për programin e studimit, dhe gjithashtu nuk mund të thuhet se ato janë efektivisht duke orientuar lidhur me tregun e punës, studentët e këtij masteri. Institucioni duhet të ndërtojë marrëveshje internship afatgjata me operatorët turistikë lokale, rajonale dhe kombëtarë, për të nxitur studentët.


	<i>Evidenca 34, Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit. Evidenca 35, Raport analitik mbi marrëveshjet e bashkëpunimit DT.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Burimi i informacionit për studentët janë Web-site i UAMD si edhe materiale promovuese, dhe stafi i programit ose stafi mbështetës. Për studentët e programit aktualisht kanë në faqen e programeve të studimit një hapësirë për log in. Aktualisht informacioni për programin e studimit nuk është publik në Web-site, pasi nuk mund të klikohet mbi të, në mënyrë që edhe kandidatët për studentë të programit të informohen për mundësitë që ai ofron, por është në listen e programeve.  <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programet-master/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programet-master/</a> <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/en/bachelor-programs/">https://www.uamd.edu.al/index.php/en/bachelor-programs/</a>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Siç edhe u tha më lart, ka munguar sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe gjatë vizitës në institucion u informuam se po punohet për ndërtimin e tij nga RASH.  <i>Vizita në IAL takimi me stafin akademik, takimi me studentët, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Në evidencën 27 dhe evidencën 29 gjenden të pasqyruara të dhënat lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin MP DNT, ku tregohet për numrin e studentëve të programit që janë të punësuar si edhe për ecurinë e tyre përgjatë programit. Nga vizita në institucion me zyrën e Alumni dhe Karrierës u gjet se nëpërmjet zyrës Alumni, në mënyrë periodike, mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë dhe të dhënat e tyre, si numra telefoni dhe adresa e-mail.  <i>Evidenca 27, Të dhëna tabelare mbi regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve të MP DNT.</i> <i>Evidenca 29, Të dhëna tabelare për punësimin real të studentëve.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



	<i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore u panë të dhënat e të gjithë studentëve të regjistruar. Nuk ka patur të larguar nga programi i studimit dhe as studentë që janë transferuar. Në regjistrat e studentëve evidentohen notat sipas lëndëve dhe rastet kur ka mospërfundim me sukses të vitit akademik.</p> <p>Aktualisht studentët nuk janë diplomuar për shkaqe sipas institucionit që lidhen me angazhimet e tyre personale. Gjithsesi procesi i diplomimit është shtyrë.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, takimi në sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i informacionit menaxhon të dhënat e studentëve (në formë tradicionale, përmes regjistrave), të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Kjo u pa në vizitën në institucion tek sekretaria mësimore.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi në sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Aktualisht departamenti i turizmit ka të dhënat e para për studentët, cilësinë e tyre dhe punësimin. Ai duhet të bazohet vazhdimisht në analizën e këtyre të dhënave për të rritur ndikimin në tregun e operatorëve turistikë.</p> <p><i>Evidenca 27, Të dhëna tabelare mbi regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve të MP DNT.</i></p> <p><i>Evidenca 29, Të dhëna tabelare për punësimin real të studentëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Sipas rregulloreve të UAMD, rregullore e FB dhe statutit të UAMD, angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese bëhet sipas mënyrës së përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.</p>

	<p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i></p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton pjesëmarrje reale të studentëve kryesisht në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike. Procedura e ndjekur e spjeguar nga takimi me zyrën e Njësisë së sigurimit të cilësisë, është shumë e qartë dhe përfaqësuese e popullimit të studentëve në UAMD. Rezultatet e anketës janë lehtësisht të matshme. Ato mbështeten nga projekti i matjes elektronike, Cleanscore, duke sjellë shpejtësi dhe efektivitet në procesin e matjes dhe vlerësimit. Gjithashtu procesi parashikon ankesat e mundshme, të cilat kanë ndodhur për shkak të gabimeve.</p> <p>Sa i përket pjesëmarrjen në vendimmarrje apo këshillim, kjo është më pak e evidentueshme nga dokumentacioni aktual.</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p> <p><i>Evidenca 44, Formati i vlerësimit të lektorëve të brendshëm.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni mban parasysh në hartimin paraprak të programit, ngarkesën e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, duke bërë një shëprndarje të tyre në programin e studimit, për secilën lëndë.</p> <p>Nuk parashikohen raste të njohjes së studimeve të mëparshme, në rregulloren e programit, përveç orientimeve të përgjithshme dhe zbatimit të bazës ligjore. Kjo situatë duhet të parashikohet edhe në rregulloren e programit të studimit dhe të informohen studentët për këtë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Sugjerimet dhe kontributi i studentëve jepet dhe merret nga lektori përgjatë semestrit, duke bërë ndryshime të nevojshme në syllabuset. Përfshirja e studentëve në baza të rregullta në mënyra të tjera, nuk parashikohet.</p> <p><i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit dhe rezultatit, duke siguruar një procedurë shumë të detajuar, të dokumentuar në çdo hap dhe efektive për të rishikuar rezultatet, përmes komisioneve specifike.</p> <p><i>Evidenca 7, Rregullorja e programit të studimit MP DNT.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga njësitë që institucioni ka për informimin për shërbimet ndaj studentëve janë: së pari departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; së dyti sekretaria mësimore, ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; së fundi, zyra e karrierës ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit.  <i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nuk mund të themi se ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve. Por mund të themi se gjatë realizimit të aktiviteteve të përditshme, zhvillohen bazuar mbi rregulloret përkatëse, mënyrat e informimit, këshillimit dhe ndjekjes së studentëve. Përdoren mjete elektronike si posta elektronike, por nuk ka një sistem të posaçëm. Ka disa evidenca për funksionimin e sistemit, por aktualisht sistem të brendshëm informacioni nuk ka në funksionim dhe sidomos nuk ka pasur asnjehere për programin e studimit.  <i>Evidenca 46, Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë Manual_Aula.</i> <i>Vizita në IAL, takimi me stafin akademik, takimi me studentët, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në	Zyra e karrierës dhe alumni është njësi e re e cila ka filluar aktivitetin në vitin 2018. Në këtë rast ajo po merret më tepër me promovimin e programeve të studimit dhe nga vizita në institucion u pa se fokusi i saj është mbledhja e sa më shumë aplikantëve për student. Por ajo nuk po mendon shumë për pjesën e studentëve pas diplomimit, për t'i paraprirë sfidave të tregut. Sugjerojmë që paralelisht me përpjekjet tek gjimnazet dhe shkollat e mesme, kjo zyrë të ngrejë një marrëdhënie institucionale të vazhduar me ish-studentët e UAMD dhe ndërtimin e një programi Alumni që mund të shërbejë pozitivisht

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	në efektin në treg të programeve të studimit.  <i>Vizita në IAL, takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra/njësia e karrierës në UAMD përpunon të ndjekë studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Kryesisht kjo zyrë bashkëpunon me departamentin, për të patur të dhënat e studentëve. Më tej, gëjkojmë se duhen ngritur sisteme për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve, për të krijuar programin Alumni për këtë program studimi, i cili është në hapat e para të tij.  <i>Evidenca 12, Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përmbushur kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në RSH dhe gjithashtu kërkesat e akteve rregullatore institucionale. Sipas <i>Statutit të UAMD (në kreun VII)</i> jepen orientimet e përgjithshme se cilat janë dhe si do të vendosen këto politika, struktura dhe procedura. Strukturat themelore janë: Njësia e SBC dhe Komisioni i SBC, këtej e tutje KSBC si dhe drejtorja e Kurrikulës, standardeve dhe Cilësisë (DKSC).



	<p>UAMD ka ndërtuar gjithashtu Manualin për sigurimin e cilësisë i cili përshkruan politikat strukturat dhe procedurat në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore dhe statutit e rregullore së UAMD.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i> <i>Evidenca 99, Manual për Sistemin e Brendshëm për Sigurimin e Cilësisë në Fakultetin e Biznesit_V.A. 2018-2019.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>KSBC është ngritur në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit, sipas statutit dhe rregullores. Komisioni, duke patur akses në të dhënat institucionale, vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UAMD- it.</p> <p>Gjithashtu ka një strategji të institucionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, si edhe kjo vendoset në fokusin e strategjisë së Fakultetit dhe departamentit.</p> <p><i>Evidenca 3, Plani strategjik.</i> <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 4.1, Plani i zhvillimit strategjik të Departamentit të Turizmit.</i> <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni i është nënshtruar procesit të akreditimit dhe është vlerësuar pozitivisht, sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 10, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen prej 4 vite dhe afat vlefshmërie deri më 06.04.2021. Nga ana tjetër, institucioni përmes rregulloreve zyrtarizon procesin e vlerësimit të brendshëm (i vendosur edhe në rregulloren e programit të studimit) oërmes ngritjes dhe funksionimit të GVB. Proceset që kanë për qëllim të promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë janë ato që shërbejnë për matjen e performancës së stafit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Politikat e UAMD mbi cilësinë paraqiten në planet strategjike në nivel institucional, në nivel fakulteti dhe departamenti. Procedurat periodike përfshijnë matjen e performancës së stafit dhe pyetësorin e studentëve.</p> <p>Kështu në synimet strategjike, vendosen thelbësisht synime të lidhura me përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie e kërkim shkencor.</p> <p><i>Evidenca 3, Plani strategjik.</i> <i>Evidenca 3.1, Plani strategjik i Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 4.1, Plani i zhvillimit strategjik të Departamentit të Turizmit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	<p>Departamenti është njësi bazë që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimit apo propozimit të kurrikulave të reja. Stafit i departamentit, përballë tregut të punës, literaturave bashkëkohore, studentëve, biznesit, nevojës për përmirësim/ndryshim dhe përmirësime të vazhduar është gjithnjë në kërkim të mënyrave të përmirësimit, rregullimeve në kurrikula, përshtatje të tyre, përmirësimit të syllabuseve të veçanta, etj.</p> <p>DKSC si struktura e ngritur për këtë qëllim, përmes Zyrës së sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional, monitoron dhe vlerëson programet e studimit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë mund të identifikojmë disa mekanizma dhe procese formale për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve. Ky proces mbikëqyrjeje dhe përmirësimi ndodh në fillim të çdo viti akademik, ku kërkohet të identifikohen përmirësimet e programeve dhe rishikime bazuar mbi të dhëna të ecurisë gjatë vitit të kaluar. Procesi është i natyrshëm përgjatë ecurisë me procesin e mësimdhënies. Ndërsa për programet e reja gjithashtu ka një proces formal i cili fillon nga departamenti me propozimin përkatës, dokumentimin e diskutimeve përmes syllabuseve dhe CV përkatëse të stafit që mendohet të mbulojë programin e studimit. Pas përcjelljes së dosjes në Dekanat dhe Rektorat, KSBC bën miratimin e saj dhe miratimi final i takon Senatit dhe Bordit të Administrimit.</p> <p><i>Evidenca 37, Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në FB V.A. 2018-2019.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Rregullorja e NJSBC, neni 6, paraqet dy pikat themelore të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, pyetësorin e studentëve dhe vlerësimin e performancës së stafit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Metodologjitë e vlerësimit janë disa. Së pari, Zyra Mësimore, si pjesë e DSKC, ndjek përputhshmërinë e programit të studimit me planin mësimor, zbatueshmërinë dhe përpikmërinë e realizimit të procesit mësimor, disiplinën dhe rregullin e zbatimit. Për këtë përdor dokumentacionin përkatës dhe gjithashtu vëzhgimet.</p>

	<p>Metoda tjetër e vlerësimit është pyetësori i studentëve, që realizohet në mënyrë të standardizuar çdo fund semestri dhe përbën bazën themelore të vlerësimit të pedagogëve nga studentët në UAMD. Pyetësori ndërtohet bazuar në shkallët e matjes së qëndrimeve dhe gjithashtu ndan veprimtarinë mësimore në disa variabla të rëndësishme përsa i përket cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Një formular tjetër që i shërben procesit të matjes është ai i evidentimit të performancës së pedagogut që merr parasysh edhe punën kërkimore shkencore të pedagogut në disa aspekte.</p> <p>NJSBC mban sipas rregulloreve përkatëse dhe rregullores së saj, edhe të dhëna statistikore të shumëllojshme për studentët, për të patur mundësi të matet efektiviteti i punës, si ecurinë e suksesit të studentëve, profilet studentore, raportet pedagog student, mundësitë e punësimit të të diplomuarve etj.</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Dokumentimi i rezultateve të vlerësimit bëhet sipas rregulloreve të institucionit dhe rregullores së NJSBC. Dokumentimi fillestar përmes NJSBC dhe zyrave përkatëse iu dërgohet Fakulteteve dhe këta ia dërgojnë departamentit përkatës. Më tej ato dokumentohen në analizat vjetore të institucionit, si dhe analizën e FB, Departamentit të Turizmit dhe programeve të studimit. NJSBC në çdo rast i dërgon Senatit Akademik rezultatet e vlerësimeve.</p> <p>Një rol të rëndësishëm luajnë në rezultatet të cilat analizohen nga institucionet dhe organet drejtuese, edhe Treguesit Kyç të Performancës (TKP), siç janë niveli i regjistrimeve, niveli i kalueshmërisë, i diplomimit etj. Rishikimi i tyre bazuar mbi rezultatet e vlerësimit dhe krahasuar me objektivat, nxjerr detyra dhe orientime të mëtejshme për drejtimin e departamentit, fakultetit dhe Institucionit në tërësi.</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Duke u bazuar në evidencat e analizës vjetore të departamentit, pasi nuk kemi në dispozicion ndonjë raport të NJSBC, shohim se ka një paraqitje të fakteve mbi programin e studimit, shpërndarjen e ngarkesës së pedagogëve në nivel departamenti, analizë të rezultateve të vlerësimit të studentëve, analizë të një pyetësori në google form (<i>ky nuk është pyetësori i studentëve për realizimin e cilësisë, ndaj edhe duhet patur parasysh që mund të mos ketë plotësuar kriteret e procedurës për besueshmërinë dhe përfaqësueshmërinë e rezultateve</i>), si dhe paraqitje të gjithë</p>

	<p>veprimtarive të përfshira dhe kërkimit shkencor të stafit akademik të departamentit. Analiza vjetore nuk fokusohet të paktën në një pjesë të saj tek programi i studimit në veçanti, por paraqet gjithë veprimtarinë e departamentit. Gjithashtu analiza nuk bën lidhjen e rezultateve të pritshme nga objektivat, rezultatet aktuale dhe cilat janë mangësitë që duhet të adresojë.</p> <p><i>Evidenca 38.1, Analiza e Departamentit për programin e studimit MP DNT.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm për këtë program studimi është kryer për herë të parë në kuadër të këtij vlerësimi, duke qenë program i hapur rishtazi. Sipas rregullores së NJSBC, koordinatori i programit (në rastin tonë përgjegjësi i departamentit) është përgjegjës për vlerësimin periodik të brendshëm), duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse.</p> <p>Më tej do të duhet të shihet se si dokumentohet vlerësimi periodik i brendshëm i programit të studimit (i ndarë në seksion të veçantë nga vlerësimi i departamentit në analizën e tij).</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Siç u përmend edhe në seksionin VI.2, kriteri 3, metodologjitë e vlerësimit marrin parasysh një sërë faktorësh dhe bazohen në instrumenta të ndryshme. GVJ sugjeron që në këta faktorë të merren më tepër parasysh sipas natyrës së programit, lidhja dhe marrëdhënia me tregun e punës, vlera e praktikave mësimore dhe përdorimi i duhur i laboratorëve në procesin e mësimdhënies. Gjithashtu tek vlerësimi i studentëve përmes pyetësorit, në pyetësor të merren parasysh në mënyrë specifike metoda inovative në mësimdhënie, duke i specifikuar ato.</p> <p><i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për</p>

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>kryerjen e vlerësimit të cilësisë. Ndër këto mund të përmendim: Metodat e drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>nuk përdoren rezultate në teste të standardizuara;</li> <li>vlerësimet e studentëve në auditor përdoren sipas intervistës në institucion, por nuk ka raportim të përdorimit të tyre në aspektin e përmirësimit të cilësisë.</li> </ol> <p>Po kështu metodat e mëposhtme përdoren (<i>sipas vizitës në institucion, takimi me stafin akademik</i>) por nuk janë të analizuar në aspektin e arritjes së objektivave për cilësinë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit;</li> <li>vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;</li> <li>rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës.</li> </ol> <p>Metodat e tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>sondazhet e studentëve dy herë në vit duke drejtuar një pyetësor për pedagogët;</li> <li>vlerësimin e mësimdhënies sipas zyrës së monitorimit të kurrikulës (nuk ka formular për të dokumentuar matshmërinë, apo një analizë vjetore të realizimit për programin e studimit);</li> <li>sondazhet e pedagogëve dhe stafit për ofrimin e shërbimeve nga institucioni.</li> </ol> <p>Në raportin vjetor gjendet informacion që mund të përfshihet në tregues të kufizuar të cilësisë vetëm përqindja e kaluesve nga njëri vit në tjetrin dhe rritja e mesatares për çdo student, ose në përqindje.</p> <p><i>Evidenca 37, Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në FB V.A. 2018-2019.</i> <i>Evidenca 38, Analiza vjetore Dep. Turizmit 2018-2019.</i> <i>Evidenca 38.1, Analiza e Departamentit për programin e studimit MP DNT.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Aktorët e brendshëm, pjesë e stafeve të FB dhe departamentit të turizmit janë të përfshirë në procedurat e brendshme të cilësisë. Përfshirja e aktorëve të jashtëm nuk është parashikuar në rregulloret dhe ndërtimin e strukturave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësë. Departamenti mbetet i hapur, por duhet bërë më shumë përpjekje jo vetëm për lidhjen me aktorë të jashtëm, por edhe për përfshirjen e tyre në proceset në vazhdimësi.</p> <p><i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i>  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të të gjitha palëve pjesëmarrëse janë të përcaktuara në rregulloren e NJSBC, përveçse në rregulloret e institucionit për përgjegjësitë e organeve dhe autoriteteve drejtuese. Gjithashtu sigurimi i cilësisë është pjesë e rëndësishme e politikave në rang institucional.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i>  <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i>  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, takimi me NJSBC, si dhe duke iu referuar rregullores së NJSBC, ajo dhe KSBC ka përfaqësuesit e saj në nivel fakulteti. Departamenti i Turizmit dhe stafi i programit nuk përfaqësohen në mënyrë të vazhdueshme, por përfshihen në detyrat e përcaktuara nga NJSBC, Komisioni apo në vendime ad hoc.</p> <p><i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i>  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit</p>	<p>Vetëm përmes zbatimit të rregulloreve të lartpërmendura disa herë mund të garantohet që përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit do të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Nuk vihet re një gjë</p>

dhe studentëve.	e tillë nga dokumentacioni apo vizita në institucion.  <i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Sipas analizës sonë dhe intervistës në institucion, nuk u pa përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë që kanë lidhje me programin e studimit, përveçse në rastin e GVB ku është përfshirë si bashkëpunëtor i jashtëm një ekspert nga DRKK. Ekziston mundësia e përfshirjes më të madhe të tyre në të ardhmen në mënyrë funksionale, bazuar mbi marrëveshjet dhe procesin e praktikave/internshipeve.  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Transparenca e politikave, strategjive dhe organizimit në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, bëhet brenda institucionit përmes komunikimit të brendshëm dhe gjithashtu përmes dokumentave strategjike, ku secili mund të ketë akses edhe përmes sistemit. Transparenca për studentët dhe aktorë të jashtëm bëhet përmes faqes së web, ku gjenden dokumentat strategjike të institucionit, statute, rregullorja etj  <a href="http://openuniversity.al/index.php/content/universiteti-aleksander-moisiu-durres/">http://openuniversity.al/index.php/content/universiteti-aleksander-moisiu-durres/</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga shqyrtimi i faqes së internetit, po dhe nga vizita në institucion, mbi shpërndarjen e informacionit lidhur me vlerësimet e programit të studimit, u pa se këto nuk publikohen, por ato diskutohen në departamente në formën e analizave vjetore dhe gjithashtu u vihen në dispozicion autoriteteve dhe organeve drejtuese.  <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i> <i>Vizita në IAL, takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit,</i>

	<i>takimi me NJSBC, Sektorin e Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit dhe Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke qenë se përmirësimi i programeve dhe përmbushja e pikave të dobëta të identifikuar është synimi i gjithë procesit dhe realizimit të monitorimit të cilësisë, masat merren për këto përmirësime në nivel departamenti, duke u bazuar edhe tek drejtimi dhe orientimi i përgjegjës të departamentit (rregulloret e UAMD, FB, Departamentit dhe programit të studimit). Nuk ka ndonjë evidencë për plan masash të zhvilluara konkretisht, por ky master është tashmë në vitin e dytë dhe duhet të evidentojë masat konkrete që janë marrë pas analizës.</p> <p>Sugjerimi i GVJ këtu është që edhe puna e GVB në rastin e periodicitetit, të evidentojë më mirë problematikat, dhe jo të përgjigjet “PO” për secilin kriter, pasi në çdo institucion sado perfekt problematikat ekzistojnë. Do të ishte më produktive që vetë GVB të identifikojë probleme të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në planin e masave të marra për vitin e ardhshëm akademik si dhe në orientimin e stafit akademik në punën e tij mësimdhënëse e kërkimore shkencore, por edhe në lidhje me aktivitetet ku duhet të fokusohet lidhur me përmirësimin me fokus programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit. Evidenca 6, Rregullore e Fakultetit të Biznesit. Evidenca 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Dokumentet dhe procedurat e ndjekura synojnë në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit në procesin e cilësisë. Nuk ka matje të këtij efektiviteti, por shihet se proceset janë përmirësuar gjatë kohës, por kjo është në përgjegjësinë e KSBC, NJSBC dhe Senatit akademik tek raportet e të cilëve GVJ nuk ka akses. Nga takimi në institucion u pa se NJSBC dhe KSBC përmes koordinorit dhe bashkëpunimit me departamentet dhe fakultetet janë të angazhuara për këtë.</p> <p>Veprimtaritë informuese dhe ndërgjegjësuese janë kryesisht të shpërndara përmes rregulloreve, vetë studentëve përfaqësues në strukturat drejtuese, javës orientuese dhe këshillit studentor. Përfshirja e studentëve të këtij programi nuk është e dukshme. Gjithsesi, duke qenë se kryesisht janë studentë të lidhur tashmë me tregun e punës, ose që kërkojnë të punësohen së shpejti, edhe gjatë studimeve, duhen motivuar ata në pjesëmarrjen në procesin</p>



	për sigurimin e cilësisë.  <i>Evidenca 2, Statuti i UAMD.</i> <i>Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 8, Rregullore e NJSBC.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Përfundime të Vlerësimit të Jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Drejtimit të Ndërmarrjeve Turistike”, ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Pozicioni strategjik i UAMD mundëson dhe krijon kushte mjaft komode për të patur natyrshëm një numër në rritje të studentëve për këtë program studimi. Departamenti për këtë program studimi ka mundësi të rrisë në të ardhmen numrin e studentëve që do të duan ta ndjekin pasi numri i bizneseve turistike në zonë është mbi 700, që do të thotë se kërkesa për profesionistë ka mundësi të jetë e lartë.
2. Nuk ka programe të ngjashme studimi në IAL të tjera publike apo private.
3. Infrastruktura për studentët dhe stafin është në nivele të kënaqshme, duke krijuar motivim dhe mundësi të mira për tërheqjen e studentëve në këtë program.
4. Lokaliteti dhe afërsia me bizneset krijojnë idenë se UAMD është vendosur në një pozicion tipik laboratorik. Pra, afërsia me kërkesën për staf të kualifikuar në fushën e turizmit është një element që i jep prioritet këtij programi, nëse shfrytëzohet në mënyrën e duhur.

**Pika të dobëta:**

1. Emërtimi i programit të studimit në gjuhën angleze në suplementin e diplomës, “Tourist Enterprises Direction”, nuk është korrekt dhe i përafshuar me atë çka ofrojnë diplomat e fushës në botë, duke vështirësuar kështu edhe njohjen në nivele ndërkombëtare.
2. Të gjitha dokumentat që lidhen dhe ndikojnë në cilësinë e realizimit të këtij programi studimi, si rregullore e departamentit, planet marketing të departamentit, rregullore e funksionimit të programit aktual, etj. janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi në kohën kur studentët e këtij programi duhej të diplomoheshin, qershor 2019 (*ndërkohë të gjithë studentët janë diplomuar në shtator 2019*).
3. Nuk ka studim të mirëfilltë tregu, qoftë cilësor apo sasior, për këtë program studimi. Mungojnë raporte të përmbledhura në formën e analizave pas diskutimeve me drejtuesit e bizneseve lokale të konsideruara si kërkime cilësore apo fokus grupe që të përafrojnë dhe justifikojnë nevojën e një diplome të tillë në tregun e punës.
4. Programi ka probleme me stafin mësimdhënës në dy drejtime:
  - a. mospërputhje e nivelit të kualifikimit të stafit me kërkesat e kuadrit ligjor. Ka staf akademik të angazhuar në mësimdhënie me gradën Msc, kur kërkohet të paktën me gradën Doktor i Shkencave. Gjithashtu, jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve janë të kategorisë “Profesor”.
  - b. mospërputhje në disa raste të fushës së kualifikimeve të stafit me lëndët përkatëse të mbuluara nga ky staf brenda këtij programi studimi.

5. Lidhur me brendinë e programit, ka probleme të strukturës dhe përmbajtjes që nuk kontribuojnë në formimin me njohuri dhe aftësim të studentëve, për shkak edhe të mungesës së studimit të tregut, siç janë:
  - a. Mungesa e lëndëve me zgjedhje;
  - b. Prezenca e ndonjë lënde që nuk i nevojitet këtij programi studimi, si psh: “Metoda kërkimi në turizëm” (pasi është Master Profesional dhe jo Shkencor), që përveç kësaj, nuk ka në përmbajtje elementë të turizmit duke mos u përputhur me fushën kryesore ku synohet të ofrohen specialistët;
  - c. Lënda e vetme bazë zhvillohet në semestrin e dytë;
  - d. Përmbajtja e syllabuseve, ku koncepte bazë dhe të rëndësishme trajtohen shpesh brenda lëndëve të ndryshme duke krijuar konfuzion njohurish tek studentët;
  - e. Përmbajtje në disa raste jo të bazuar në titullin e lëndës por të përgjithshme dhe jo të thelluar.
6. Literatura në disa raste nuk përfshin literaturë të 5 viteve të fundit.
7. Mungesa e ofrimit të trajnimeve, praktikave apo eksperiencave në njësi hoteliere apo operator turistik, të konsideruara si ndërmarrje turistike, vështirëson aplikimin e njohurive në praktikë gjatë studimeve. Trajnimet e kryera janë bërë jo në ndërmarrje turistike dhe mungon dokumentacioni shoqërues, si marrëveshjet, programi dhe agjenda e trajnimit.
8. Departamenti nuk ka bërë sa duhet për të përafruar dhe përdorur burimet njerëzore lokale (studentët) me nevojat në rritje që ka tregu lokal, përpos atij kombëtar, për njohuri, aftësi dhe dije në fushën e turizmit, veçanërisht në atë të menaxhimit të ndërmarrjeve turistike.
9. Studentët nuk janë të orientuar për të kryer diplomat e tyre drejt nevojave reale lokale që kanë dhe përballen ndërmarrjet turistike. Në këtë mënyrë vështirësohet funksioni bazë dhe qëllimi për të cilin zhvillohen dhe evoluojnë departamentet, ai i shërbimit të nevojave lokale të tregut në rradhë të parë me studime, raportime, statistika, diploma e qasje aktive ndaj nevojave me një mbështetje cilësore, edhe përmes studentëve apo punimeve të vetë stafit.
10. Nuk ka të dhëna për marrëveshje apo qoftë edhe komunikim zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektor, lidhur me punësimin.
11. Programi i studimit nuk përdor sisteme të brendshme të menaxhimit të informacionit.

### **Rekomandime:**

1. Nevojitet të korrigohet emërtimi në anglisht i programi të studimit në suplementin e diplomës.
2. Kryerja e një studimi tregu për këtë program studimi, bazuar tek tregu i punës, me të dhëna cilësore dhe sasiore.

3. Të shihet në të ardhmen mundësia e përmirësimit të stafit akademik me staf të ri, të kualifikuar drejtpërdrejt në fushën e turizmit (me doktoraturë në këtë fushë), qoftë nga burime të brendshme, por edhe nga burime të jashtme.
4. Është e nevojshme futja dhe përfshirja e atyre lëndëve dhe moduleve që plotësojnë mungesën e tregut me aftësi, njohuri dhe kompetenca të domosdoshme.
5. Ky program studimi ka nevojë për përmirësime cilësore të strukturës së programit, të përmbajtjes së çdo syllabusi, të sigurimit të mos përplasjes së koncepteve, të konsultimit me ekspertë të fushës, akademikë, drejtues të ndërmarrjeve turistike të zonës, pra, me të gjithë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në zinxhirin e vlerës. Ka nevojë për të tërhequr dhe reflektuar feedback të studentëve dhe stafit mësimdhënës, të përballjes dhe diskutimeve përfutuese që rezultojnë dhe të një përjasjeje sa më optimale të çdo rezultati në programin e ardhshëm të këtij masteri.
6. Përmirësime cilësore të programit bazuar tek përfshirja e të gjithë stakeholderave në tryeza cilësore të rumbullakta, në fokus grupe, përfshirja e studentëve në to si dhe konsultimet me ekspertë dhe akademikë.
7. Përditësimi i literaturës me literaturë të 5 viteve të fundit.
8. Ndërtimi i marrëveshjeve me strukturat turistike në nivel lokal, por edhe rajonal e më gjerë, për studime, internshipe, trajnime të vazhduara për tu shfrytëzuar afërsia me kërkesën e tregut të punës si element ku duhet të mbështetet strategjia e ardhshme e këtij programi.
9. Orientimi i diplomave të studentëve drejt nevojave të operatorëve dhe ndërmarrjeve turistike.
10. Përdorimi i sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit, për këtë program studimi.

**Conclusions of the External Evaluation of the second cycle study program, Professional Master in “Direction of Tourism Companies”, of “Aleksandër Moisiu” University, Durrës**

**Strengths and affirmations:**

1. The strategic position of UAMD enables and creates quite comfortable conditions to have a natural increasing number of students for this study program. The Department has the potential to increase the future number of students for this study program that will want to pursue it as the number of tourist businesses in the area is over 700, which means that the demand for professionals has the potential to be high.
2. There are no similar study programs in other public or private HEIs.
3. Infrastructure for students and staff is at satisfactory levels, creating good motivation and opportunities for attracting students to this program.

4. Locality and proximity to businesses create the idea that UAMD is located in a typical laboratory position. So the proximity to the demand for qualified staff in the field of tourism is an element that gives priority to this program if used properly.

#### **Weaknesses:**

1. The name of the study program in English, in the diploma supplement, "Tourist Enterprises Direction", is not correct and does not represent what other similar programs in the field are offering worldwide, thus making it difficult to recognize the studies at international levels.
2. All documents related to and directly affecting the quality of the implementation of this study program such as Regulation of the department, marketing plans of the department, regulation of the study program, etc., have been approved and entered into force at the time when the students of this program had to graduate, June 2019 (*all students graduated in September 2019*).
3. There is no proper market study, whether qualitative or quantitative. There is a lack of summary reports in the form of analysis after discussions with local business leaders considered qualitative research or focus groups to approximate and justify the need for such a degree in the labor market.
4. The program has problems with teaching staff in two directions:
  - a. discrepancy between the qualification level of the staff and the requirements of the legal framework. There is academic staff engaged in teaching with MSc, when required at least with the degree of Doctor of Science. Also, not all main staff for the course/module is in the "Professor" category, as required.
  - b. in some cases, there is a discrepancy between the qualification field of the staff and the relevant subjects covered by this staff within this study program.
5. Regarding the content of the program, there are problems of structure and content that does not counteract the capacity building with knowledge and training of students, due to the lack of market study, such as:
  - a. Lack of electives;
  - b. Presence of subject, not needed in this study program, such as: "*Research method in tourism*" (as it is a professional and non-scientific master), which, in addition, does not contain elements of tourism, not matching the main field where it is intended to provide specialists;
  - c. Basic subject taught in second semester, not in first one;
  - d. The content of syllabi, where basic and important concepts are often treated within different subjects creating confusion of knowledge in students;
  - e. Content not based on the subject title but general and not in-depth concepts.
6. Literature in some cases does not include literature of the last 5 years.
7. The lack of providing training, practices or experiences in hotel units or tour operators, considered as tourist enterprises, makes it difficult for application of practical knowledge during studies. The trainings were conducted not in a tourist

enterprise and the accompanying documentation such as the agreements, the program and the training agenda, is missing.

8. The department has not done enough endeavors to approximate and use local human resources (students) with the growing needs of the local market, as well as the national one, for knowledge and skills in the tourism field, especially in the management of tourism enterprises.
9. Students are not oriented to carry out their diplomas towards the real local needs that tourism enterprises have and face in the tourism market. So, it is difficult to implement the basic function and purpose for which the department is developed and should evolve, that of serving the local market needs in the first place with studies, reporting, statistics, diplomas and active access to needs with quality support through students or staff research.
10. There is no data on agreements or even official communication with employers in the tourism field, their requirements and needs, employment opportunities for students and the expected developments in the sector, related to employment.
11. The study program does not use Internal Information Management Systems.

### **Recommendations:**

1. The english name of the study program in the diploma supplement needs to be corrected.
2. Carrying out a market study based on the labor market, with qualitative and quantitative data.
3. In the future, the department should take in consideration the possibility of improving the academic staff with new staff, directly qualified in the field of tourism (with a doctorate in this field), both from internal sources and from external sources.
4. It is necessary to introduce and include those subjects and modules that complement the lack of market with market skills, knowledge and competencies.
5. This study program needs qualitative improvements of the program structure, the content of each syllabus, the provision of non-collision of concepts, consultation with experts in the field, academics, heads of tourist enterprises in the area, ie with all actresses. and the factors that affect the value chain. There is a need to attract and reflect the feedback of students and teaching staff, the confrontation and the resulting discussions and an optimal approach of each result in the future program of this master.
6. Qualitative improvements of the program should be based on the inclusion of all stakeholders in qualitative round tables, in focus groups, student involvement in them and consultations with experts and academics.
7. Update of the literature with literature of the last 5 years.
8. Agreements should be made with the tourist structures at the local level, but also regionally and beyond, for studies, internships, continuous trainings to take advantage

of the proximity to the demand of the labor market as an element on which the future strategy of this program should be based.

9. Orientation of students diplomas towards the needs of operators and tourist enterprises.
10. Usage of internal management information systems, for this study program.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica
2. Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha

### Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			X	